

INTERVISTË ME BAJRAM KAFU KINOLLIN

Gjakovë | Data: 24 maj 2016

Kohëzgjatja: 199 minuta

Të pranishëm:

1. Bajram Kafu Kinolli (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Noar Sahiti (Kamera)
4. Anna Di Lellio (E pranishme)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Bajram Kafu Kinolli: Unë jom Bajram Kinolli, si i vogël jom konë Bajram Kinolli, tash m'thirrin Kafu. Jom lind n'Gjakovë, n'shpi (qeshë), në qit ambient qitu {tregon dhomën}. Kom lind gjashtë kilogram (buzëqeshë) edhe jam i pesti fëmi. Motra ka ardhë masi une i kom bo shtatë vjet, domethonë e kom rritë une, shkojsha n'shkollë. Mama e ka emrin Sofije, osht' prej Mitrovicës, o ardhë këtu, o martu shumë e re. Babi osht' prej Gjakovës. E kom ni vëlla ma t'madh që quhet Ali, tash e mban postin e babës, osht' sheh. Osht' motra, që osht' e martume këtu afër Gjakovës, Adile e ka emrin. Akile, osht' motra e dytë dhe fëmija i tretë osht Hasani, atëhere jom une edhe Zejnepi. Kështu jemi familja e ngushtë.

Si i ri, oha, *where to start?* [ku me fillu?] Çka mbaj n'mend si i ri, une gjithmonë e mbaj n'mend veten me ni qosh t'u lujtë vetëm zakonisht, si i vogël. Edhe zakonisht kisha marak me bo eksperimente me hapa [tableta], s'e di pse, i kisha shumë fiksim me bo eksperimente, me dalë naj komponent ndryshe, edhe po meno... s'jom konë asi tonë kohën *spoiled* [i lazduar], jom konë tonë kohën i urtë, kom nejtë me ni qosh, edhe kom pasë qef me ngu tonë kohën. Me babën jom konë pak ma shumë i lidhun për shkak që babën e kom pasë sheh edhe m'ka marrë tonë kohën me veti ashtu. E maj n'mend kur jemi nisë gati bashkë për Prizren n'komë... o ni katund para Prizrenit, edhe i kemi bo përafërsisht njo tetë a nantë orë t'u ecë. M'majke n'qafë, ose ecshim n'dorë, m'kallxojke sene.

Baba jem o konë njeri që shumicën e kohës ka pajtu gjaqe, o konë asi njeri që gjithmonë dojke me bo mirë, pa marrë parasysh kush osht' tek osht'. Edhe ka pasë shumë marak me shku nëpër oda, me ngu ni nejtë që o konë, këta i thojshin... po meno, zijaft n'atë kohë edhe tona na merrke me veti edhe thojke, "Kur t'hijmë aty mrena, duhesh me nejtë mirë edhe me ngu se përnime mëson shumë sene. E di që s'i kupton qetash, po nashta ma vonë i kupton në qoftë se je i meçëm", zakonisht, tonë kohën rrugës. Për shembull nji rast tjetër që u konë kur jemi shku në Nivokaz, është teqja edhe tyrbja e sheh Islamit kur patëm shku atje. Unë për herë t'parë që i kom pasë nja gjashtë-shtatë vjet, para se me lind motra, e morrëm, me bicikëll patëm shku, pat shpërthy guma. Edhe tash t'u ecë rrugës i kishim edhe njo ni orë për në Nivokaz, osht' ni katun këtu afër, po meno s'osht' afër i ka 25

kilometra, 20 kilometra qështu diçka. Edhe knojshim, zakonisht knojshim ilahi edhe s'e di, o konë... osht' shumë interesant kujtimi me babën, osht' shumë... s'kom mujtë me përjetu ashtu qysh duhet.

Erëmirë Krasniqi: N'cilin vit ke lind?

Bajram Kafu Kinolli: Uhm.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë ajo kohë? A mundesh me e përshkru?

Bajram Kafu Kinolli: N'cilin vit kom lindë unë? Une n'85-tën. Në '90-tat, në '92 ka lind motra, domethonë krejt jonë konë nëpër shkolla. Vëllai i madh ka punu n'atë kohë, që o konë pak ma i... po menoj shkollat e mesme n'Gjakovë nuk kanë funksionu prej '92-shit. Në shkollë fillore, zakonisht jemi konë n'shkollë paralele se jonë konë kah tri ndërrime, besa kah katër. U dufshe se jonë konë serbët edhe shqiptarët, unë jom konë n'shkollë shqiptare. Osht' interesant... mama dojke me na shti me vëllain e mesëm Hasanin, me na shti bashkë n'shkollë edhe pse ai dy vjet ma i vjetër se une, dojke me m'shti mu shumë ma heret n'shkollë se menojshe, mama e dijshe që, menojshe që une jom shumë ma *advanced* [ma i pjekun] se sa n'atë kohë që fëmija ishin. Unë tonë kohën folsha, dijshe me shkru, me lexu, krejt i dijshe kur i kom pasë pesë vjet, se prej motrës t'u msu edhe dojke me m'shti, po ata s'ëm patën pranë. Kështu që prita edhe ni vjet se u tutke me na çu vetëm, se u konë bajegi kohë e vështirë n'Gjakovë. Në '91, m'shtini... ka dashtë me m'shti n'shkollë, masnej në '92 kom hi n'shkollë, n'klasë t'parë. Edhe foshnjore s'kemi mujtë me shku sepse s'e di, s'kanë pasë kohë këta me shku me m'marrë, me i çu fëmijë. Mama m'ka punu n'spital, hala punon, babi ka punu në Metalik, n'fabrikë të telit, o konë teknik, ka pasë bajegi punën e ronë, kur vijke prej punës o konë... veç bojke tush edhe flejke gjum.

Eh për shkollë o konë shumë interesant aty. Ajo msusja Lavdije, hala e maj n'mend, o konë shumë e mirë ajo, o konë me flokë kaqurrela, shumë e bukur, i ka pasë sytë e zi, hala e maj n'mend me buzëqeshje tonë kohën. O konë shumë e re, si msuse na dojke shumë, jemi konë dy romë n'klasë.

Erëmirë Krasniqi: A kanë qenë klasët e përzime?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, veç dy romë kanë qenë. Po menoj, e përzime osht' edhe ajo faktikisht. Po nuk kemi pasë o njeri... s'e di une personalisht, nuk e ndjeshim këto para luftës shumë, kush osht' me ngjyrë, kush osht'... unë s'e dijshe faktikisht n'atë kohë. As s'e maj n'mend që kom pasë najsen edhe pse s'e di, klasa e parë, klasa e dytë s'o konë bash ashtu që e maj n'mend najsen t'veçantë. E kur jemi dalë n'klasë të tetë, n'klasë t'tretë faktikisht, jemi shku n'shkollë t'muzikës t'vjetër në "Prek Jakova", që o konë prej ktushit me ecë përafësisht dy kilometra e gjysë. I bojsha gjysë ore, katërdhetë minuta, çdo ditë n'shtatë t'mëngjesit, se n'tetë fillojke. Kanihere kur i kishim tri ndërrime, u duhke me u çu n'gjashtë, që n'shtatë fillojke shkolla. T'shtunën u duhke me dalë kanihere n'shkollë për me kapë ashtu. Edhe zakonisht kemi pasë te na probleme, se u konë mahalla e serbëve n'mes t'rregës, gjithmonë o konë mahalla serbe n'mes t'qasaj shkollës edhe kemi pasë

tona herë problem. Gjithmonë u rrehshim, unë nuk e dijsa pse ndodhë kjo, po veç thojke, “Ndodhë se osht mahallë tjetër. Ata jonë serbë, ne jemi shqiptarë edhe duhet diqysh me mbrojtë njoni-tjetrin.” Diqysh ose me na rrehë, kur na nxijshin vetëm na rrehshin.

Erëmirë Krasniqi: Qysh i ka përjetu familja këto vite shumë problematike? Osht’ kërku prej njerëzve me u identifiku diqysh, me marrë anë po menoj.

Bajram Kafu Kinolli: Kqyre, zakonisht mu familja nuk m’ka trajnu faktikisht shumë n’atë aspektin kush jemi na, çka jemi na, pse jemi na qështu, se nuk osht’ folë n’kohën e tyne faktikisht, se u konë Jugosllavi, u konë jugosllav vend. Ata kanë... po menoj deri në ’92-shin ata jonë konë super mirë, jonë konë, se kanë pasë punë, jonë konë krejt... po menoj baba e ka pasë rrogën shumë t’mirë që me shku... Me një rrogë kemi mujtë me shku, po menoj, n’deti, plus paret teprojshin, krejt familja. Edhe pasi ka vdekë gjyshi, qatëhere edhe po menoj, edhe kur kanë protestat e mëdhaja që u bonë n’Mitrovicë në ’89-shin, që ke një kaos aty. Faktikisht na jemi konë t’u shku n’Mitrovicë qatëhere, unë jom konë n’autobus që na ka ra me fletë n’autobus 24 orë gati.

Erëmirë Krasniqi: A po na përshkruanë çka ka ndodhë?

Bajram Kafu Kinolli: Okej, kem pasë me shku te daja, unë për herë t’parë p’e maj n’mend, e maj n’mend që kom shku te daja ashtu me autobus se nuk mujshim me udhëtu prej... mama që m’kallxon që nuk lejshin me udhëtu prej Gjakovës në Mitrovicë njerëzit, se u bo nifar ore policore, ku ta di une. Atëhere në ’89-shin vdiq gjyshja dhe u dashtë me shku për asi, për vorrim. Edhe une te daja, mu s’ëm kanë kallxu që o deke gjyshja diqysh, une biletë, une as s’e njoh gjyshen kështu, s’e kom pa se s’na kanë leju me shku me pa. Edhe e maj n’mend shumë mirë sirenat, e maj n’mend shumë mirë gazin lotsjellës që na djegshin shumë sytë. E maj n’mend mama që o shku ka ble, ka marrë kepë me ni pazar shumë afër aty se na ishim n’qendër t’Mitrovicës, t’bllokumë. Edhe e maj n’mend shumë do njerëz që vijshin me na jepë do qumësht e ksi sene që me i la sytë n’autobus, se po menoj, autobusat qysh jonë konë t’vjetër, ato s’jonë konë t’izolune edhe qaty kemi nejtë derisa u qetësu situata, deri sa u bo terri, unë kom fletë n’gjum edhe s’e di mo, veç kur e kom pa veten n’shipi ashtu. E maj n’mend kepën n’hunë që e kom majtë tonë kohën {e vnon dorën te goja}, kështu kepën e madhe qekaq (qeshë), qato e maj n’mend.

Eh s’e di, osht’ shumë interesant, unë me mamën tem, me babën, kurrë nuk kanë folë që osht’ kah bohet luftë, sikur s’e kanë pasë ato me na shti frikën që, “Kqyre, osht’ kah bohet luftë” deri kur osht’ bo ’96. Kur parës i hupi vlera shumë, që mama edhe baba punojshin faktikisht, por një rrogë o konë ni bukë me ble n’ditë. Qatëhere jemi konë shumë keq. Qatëhere u konë ekstremi ma i madh që... une qatëhere e kom ni faktikish çka jonë konë t’u përjetu familja, unë i kom pasë përafërsisht tetë a nantë vjet qashtu. Edhe çka me bo? Me vëllaun e madh, vëllaun i madh e ka pasë kolicën e madhe kështu me tri rrota. Zakonisht dilke n’pazar me punu që m’i ble biletë dhetë bukë. Tonë ditën punojke që n’fund me i marrë dhetë bukë për nesër. Masnena, une edhe vëllaun i mesëm, baba na japi pare me ble cigare, me i ble tri paqeta cigare që me i shitë pak ma shtrejtë. Edhe bile me mujtë

me ble naj qumësht ose naj djath, ose najsen. Po shkollën nuk na nalshin diqysh. Me bo mos me shku n'shkollë, kërshitke shuplaka {e tregon shuplakën} (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhke me fëmitë tjerë [të familjes], qysh e kalojshin ditën, çka përjetojshin?

Bajram Kafu Kinolli: Mama me motrat punojshin nëpër familje, pastrojshin për shumë pak pare, shumë pak pare diqysh. Nashta punojshin me i la shkallët e banesës, sa me thonë qetash tetë euro për ni mujë. U dashke me shku çdo të tretën ditë me i la. I kishin disa banesa për shembull, po kish shumë njerëz t'papunë, qaq shumë njerëz t'papunë, nuk u shihshin aty a jonë romë, a jonë shqiptarë. U dukte dikush me punu edhe me hongër, qashtu u konë. E maj n'mend nja gjashtë mujë ditë unë shkojsha me mamën aty, ftohtë i madh. Shkojsha me mamën me i nihmu diqysh se... domethonë, shkojshim i lajshim ato se mama dilke n'punë n'ora shtatë. Shkojshim n'pesë sahati u nisshim, i lajshim ato, për ni orë i kryjshim. Ajo shkojke n'punë, une shkojsha n'shkollë. I kisha cigaret me veti, u kthejsha, i shitsha cigaret, i blejsha çka kishim nevojë për shpi. Domethonë edhe vëllau e ka pasë qështu. Atëhere vëllavi e nali shkollën kejt, i mesmi. Nuk shkojke n'shkollë, se a din qysh... nuk e shihke t'arsyshme mo me shku n'shkollë, diqysh o konë shumë... masnej ia nisën edhe me na shti me pagu. Po menoj neve na kanë shti me pagu si romë shkollën shqipe. Nuk e di a kanë pagu edhe shqiptarët, nuk e maj n'mend qato.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë ajo si kontribut që komuniteti ia ka jepë shtetit t'Kosovës?

Bajram Kafu Kinolli: Po, po m'doket që osht' ai tre përqindëshi.

Erëmirë Krasniqi: Po.

Bajram Kafu Kinolli: Edhe o konë bajegi si shumë e madhe për neve me e pagu. Ni person, për ni semestër po m'doket o konë sa e maj n'mend o konë pesëdhjetë marka.

Erëmirë Krasniqi: Po. Çka ka ndodhë me gjuhën e jujë si romë?

Bajram Kafu Kinolli: Une si familje... po menoj na jemi, po menoj, deri n'brezin e pestë që kanë folë shqip. Kanë shku nëpër... domethonë jonë njerëz që jonë konë ma shumë me shqiptarë se sa... po menoj, gjithmonë kanë pasë qef... gjyshi gjithmonë m'tregojke që, "Djali jem, kqyre nipi jem, kqyre loçka jeme," ma bojke tonë kohën, "na folim shqip, neve na ka hupë gjuha. Po s'kem çka me bo. Na jemi ata që folim shqip. Neve na thojnë magjup," tonë kohën na përmendke, "po nuk osht' fjalë e keqe ajo". Qështu e ka pasë tonë kohën. Ai e ka pasë, tash e kuptoj, që e ka pasë që, mos u nxejë ti n'qoftë se t'thojnë magjup, ti veç vazhdo, e ka pasë qat qëllimin. Osht' ky gjyshi jem këtu {tregon fotografinë në mur}, nalt atje, që e kam emrin e tij. Edhe, s'po di, o konë shumë interesant.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë forma t'prezervimit të kulturës t'ujë i keni pasë, ma t'institucionalizume?

Bajram Kafu Kinolli: Kqyre na përveç... gjyshin e kom pasë violinist, po o konë qaq i demoralizumë prej asaj shoqnie komuniste, domthonë koha komuniste, kur je konë muziqar s'o konë kohë shumë e mirë se s'ka pasë shumë pare. Domethonë ky që ka jetu n'vitet e '60-ta, nuk ka pasë shumë pare për muzikë. Edhe kur i ka pasë, sa e maj n'mend si storie që m'tregojke gjyshja, kur i ka pasë, kur u martu, i ka bo dy-tre fëmijë, i ka pasë 24 vjet, e ka thy violinën edhe kurrë s'e ka prek mo. Kurrë me dorë s'e ka prekë.

Gjyshen e kom pasë defatore, o konë shumë e mirë. Veç ni here n'jetë teme m'ka ra rasti me ni kur para se me u paralizu, o konë n'paralizë katër vjet e fundit. Para se me u paralizu, e ka marrë defin, se a din qysh e lutshim na o njeri, "Hajde kallxona kush je ti?" Diqysh, "Tonë e dijmë që ti je konë defatore shumë e mirë, knoshe shumë mirë". Edhe ka knu ashtu, ka knu super, shumë o konë moment i mirë kur e kujtoj qitash. E për shembull, mama o konë, kjo mama ka studiu, ka shku n'shkollë fillore në kontrabas.

Erëmirë Krasniqi: Përnime a?

Bajram Kafu Kinolli: Po, osht' shumë interesant. E kanë martu se kanë bo asi *matching* [martesë me msit], pa u pa, pa kurgjo edhe u dashtë me ndërpre faktikisht shkollën. E ka pasë atë orën e muzikës, speciale që e pat zgjedhë kjo, o konë kontrabas diqysh. Edhe osht'... n'Mitrovicë po, n'shkollë t'muzikës n'Mitrovicë. O konë njo prej nxansave ma t'mirë, e patën çu n'Rijekë a s'di çka. O konë shumë e mirë kështu, ka pasë... n'gara merrke pjesë për Mitrovicën. O konë shumë, shumë e mirë o konë. Edhe hala i kena do dokumenta t'saja, kështu t'shkollës që i ka. Krejt pesëshe o njeri, diqysh krejt pesëshe i ka pasë, ashtu shumë o konë e mirë. Edhe o konë tona herë ashtu e butë, e mirë me neve. Gjithmonë o konë shumë... e dojke shkollën, e neve s'na ka nalë. Edhe pse u martu këtu, e ka pasë, vëllain tem e pat lindë, domethonë s'e ka kry shkollën fillore, e ka pasë edhe ni vjet me kry, o ardhë këtu ka vazhdu e ka kry shkollën. Edhe po meno, jo që ka bo najsen që e ka kry shkollën fillore, po thjeshtë s'e ka lonë n'gjysë, diqysh mos me kry bile shkollën fillore. Që thojshin përpara, thojke, "Pa shkollë fillore nuk bohesh as pastrus" (qeshë). Jonë konë do fjalë që sa herë i meno, jonë konë shumë interesant.

E si institucion për shembull, daja i babës tem, tash po flasim kah ana e kulturës osht Hadi Bajrami. Osht' njeri prej njerëzve që ka kriju muzikë gjakovare, osht' krijusi noshta ma i madh gati në Gjakovë, kështu me Hajdar Dushin, me Qumilin e Vogël ka knu. Kemi shumë video t'vjetra me to. Ka shumë kongë t'tijna, ka shumë kongë për to faktikisht. Edhe une personalisht, kohën e fundit... na kemi nejtë n'kohë t'luftës në '99-shin qajo bombardimet kur kanë qenë, edhe kur kanë qenë ofensivat e mëdhaja, mas ni muji këtu që kemi nejtë n'podrum, ashtu te ni shpi, veç me tulla t'kuqe, n'podrum kemi nejtë ni mujë ditë. I kemi pasë edhe... sa e maj n'mend edhe njëzet veta tjerë shqiptarë që jonë konë. Që... diqysh nuk munesh me ju thonë, "Jo" njerëzve, diqysh, kanë nevojë për podrum. Ishin... tash na nuk e di shim ku kanë me gjujtë ata, ose ku kanë me hi, ose kush o ka na gjunë, a o ka na gjunë NATO, a o ka na gjunë Serbia, a kush osht' këtu. Diqysh shumë osht'

konë... kanihere bojshin kësi fore kishe NATO, a këta gjujshin vet diqysh. Edhe po menoj, qashtu na tregojshin t'familjes se, zakonisht o konë NATO që ka bombardu, s'ka pasë nevojë, po menoj venet specifike ka pasë gjujtë.

Eh mas ni muji kena jetu n'lagjen "Sefa", mahalla e Sefës i thojshin, e kur jemi dalë prej ktushit, domethonë ni grumbull prej shpisë jonë konë krejt komplet kolona e madhe prej naltit atje osht' nifar lumi, ni rekë¹ e vogël ashtu. E maj n'mend si sot, o konë qaq zyrtë, qaq zyrtë o konë, a din asi i zyrtë i terrët o njeri, n'mëngjes qasi terri. Po o konë dhetë, s'o konë qaq vonë, po o konë shumë terr, shumë vranët o konë, si me pasë kajtë edhe qielli, qashtu u doke. Edhe krejt n'turmë qashtu, t'u lëvizë, t'u lëvizë.

Erëmirë Krasniqi: E çka ka ndodhë me Hadi Bajramin?

Bajram Kafu Kinolli: Po, m'fal se... *fuck* lufta (qeshë). Po, për qato deshta me u lidhë te Hadi Bajrami se na shkumë te Hadi Bajrami, n'a ndanë faktikisht prej turmës që me shku te Hadi Bajrami, me shku n'mahallë t'Sefës ku jetojke Hadi Bajrami, ku e kish shpinë e vetë. Ai jetojke vetëm se fëmitë i kish krejt jashtë, i kish nëpër Gjermani e ksine. E kish shpinë e madhe edhe mujke me na majtë neve se na ishim tetë veta diqysh. Plus vllau i madh o martu, faktikisht në '98-shin o martu, e e kishim edhe nusen e re diqysh.

Kështu që, shkumë te Hadi Bajrami, e Hadi Bajrami o konë një prej njerëzve ma... ma t'çmendun, s'e di, s'kom pa une asi njeri, shumë *open-minded* [i hapun], s'ia nijke, shumë *chill* [i relaksumë] o konë. Tonë kohën kallxojke storie qysh ka kalu nëpër kafe atje, çka ka bo me Qumilin e Vogël, ashtu do storie t'vogla, vica tonë kohën kallxojke, fore. E me to une dy vjet, tri vjet e fundit domethonë, lufta kaloi, ai met vetëm, o konë bajegi shumë smutë prej veshkëve edhe djemtë s'kanë mujtë n'atë kohë me ardhë. Po menoj, deri në 2000-shin, s'ka mujtë kërkush me ardhë n'Kosovë edhe unë kom nejtë me to. Ai qaq shumë m'i ka mësu do sene n'muzikë, për shembull m'kallxojke për muzikën e vjetër, m'kallxojke për artistë t'vjetër, i bijke sharkisë edhe knojke. Eh kom msu shumë prej tijna si muzikë. S'e di, o konë njeri ma karizmatik, unë s'kom pa najhere, s'kom taku. O konë qaq i shlrë, folke me mu si me m'pasë ni shok, që une s'e kom pasë prej prindërve qato se jonë konë bajegi shumë n'stres prindët, gjashtë fëmi a din. Ai o konë një prej njerëzve që m'ka... ashtu {përplasë shuplakat} *come on, move on, move on* [hajde, ec tutje, tutje] diqysh. Edhe i pëlqejsha qysh i knojsha senet, knojshim bashkë zakonisht tonë kohën. E merrke ni gotë raki, zakonisht e ka pasë njo deri n'dy gota raki. E ma bojke, "Kqyre, po ta qes veç gjysë gote raki, veç kujdes" diqysh, "kujdes, e di që po ta kona, veç gjysë gote". I kisha 14 vjet ashtu (buzëqeshë). "Gjysë gote, lage nihere." Atëhere i hijshim me knu, u bojshin tri-katër orë njeri ashtu, knojshim pa u nalë hiç. Ashtu bash knojshin, ashtu super.

E shumë interesant o konë kur ni natë une ashtu si i ri mas luftës, zakonisht i kom pasë qef shumë rollerat, nashta s'e di jom konë i vetmi n'qytet që dilsha me rollera n'Gjakovë. Ashtu kqyrshin, *what*

¹ Serbisht: *reka*, lum.

the fuck is this guy [çka dreqi osht ky tip], une ashtu ma chill ma.... shkova ia çova do pare diçka, ah i bleva cigare dajës edhe ia çova do pare tjera që i kishin ardhë prej, kishin atëhere Western Union o konë, hala osht' faktikisht. Edhe... se ai s'mujke me dalë, s'mujke me lëvizë se o konë bajegi shumë keq, u ajke shumë. Atëhere doktorët s'punojshin njeri, kërkush s'mujke me kqyrë edhe qat' natë i thashë, "Dajë unë s'po muj sonte me ardhë se kom test nesër," isha n'shkollë t'mesme une atëhere, "kom test e duhna me msu." Diqysh, e dijsa kur t'shkoj te ai s'duhet tjetër, veç duhet me pi ka ni gotë raki edhe me ia nisë me knu kah tri-katër orë. Edhe qat' natë e lashë vetëm, e qat' natë vdiq ashtu. Shumë palidhje u nijsha n'atë moment, po ma vonë e kom kuptu që okej, vdekja nuk osht' ku me ditë çka, diqysh o konë shumë normale se ai o konë edhe i vjetër kështu. Po menoj, ai tonë kohën ma bojke kqyre, "Hajt shko sonte n'shpi" diqysh, tonë kohën ma bojke, a qat' natë dojke me nejtë diqysh, dojke ai me knu atë natë, po unë s'ia plotësova atë dëshirë diqysh, s'mujsha e nejtë, e kisha atë ndjenjë që du me shku n'shpi e me msu, nesër kom test matematikë e ku ta di une. E shkova n'shpi, e n'mëngjes... E ai o konë njani që m'ka inspiru ma s'shumti me bo muzikë, me knu. O konë njoni prej njerëzve që m'ka japë do informata shumë t'mira edhe m'ka msu ashtu me pasë kondicion për me knu.

Erëmirë Krasniqi: Kafu, a kthehem pak ma përpara... po m'intereson ma shumë ...

Bajram Kafu Kinolli: M'fal une jom shumë... veç kthem qashtu ma mirë.

Erëmirë Krasniqi: Po de, po nuk po du me t'pengu n'rast që t'vijne ma natyrshëm detajet, s'po du me t'pushirat.

Bajram Kafu Kinolli: Po de, normal.

[Intervistuesja e pyet folësin rreth përvojës së tij dhe të familjes së tij, se si ka qenë të jetosh në mes të dy kulturave, asaj serbe në njërën anë dhe shqiptare në tjetrën. Pyetja është prerë nga video intervista]

Bajram Kafu Kinolli: Unë s'muj me thonë për shembull, për prindët e mi kurgjo se zakonisht nuk flasin për qasi emocione. S'kanë qef edhe kurrë s'kanë pasë qef me folë kush çka na ka bo, pse na ka bo, nuk e di pse e kanë qashtu tripin edhe s'kom insistu qashtu ma shumë. Po, me kohë e kom kuptu... n'shkollë. N'shkollë o konë, n'klasën e katërt, pestë, qatëhere ia ka nisë qajo ndamja diqysh. Diqysh osht' shumë interesante, shumë personale për shembull. Krejt e kanë pasë n'klasë naj simpati, osht' shumë... kanë pasë naj simpati me femna, për shembull une edhe ai shoki nuk e kishim diqysh, se nuk rrijshin me neve masnena. Nuk e kisha ato... s'e di, e kishin atë... u ndanë o njeri njerëzit n'klasë t'pestë diqysh, u ndanë klasat. Na rrijshim masnej n'bankë t'fundit, nuk e kishim atë msusen Lavidje që na majke bashkë {bashkon duart}, diqysh na majke tonë kohën me dashni. Tash u bonë dhetë profesorë faktikisht. Edhe ata ishin shumë t'frustrumë, ata nuk dijsin me kontrollu mo. M'u konë n'qat pozicion ku s'je as me ata, e as me këta, e që duhesh me u përmbajtë në njonën anë, unë s'e di... ka po menoj, osht'... hyp se t'vrava, zhdryp se t'vrava diqysh.

Shumë thjeshtë ashtu osht', s'po di qysh me e spjegu ma tepër ato, o konë bajegi shumë vështirë njeri.

N'kohën e Serbisë që e sundojke n'atë kohë, na rrejshin, s'na lejshin me punu, s'na lejshin me shku n'shkollë, i merrshin shkollat. Erdhën Izbeglicat², erdhën, krejt aty lëshojshin gaz, qitshin ashtu kanihere gaz veç me na qitë prej shkollës. E masnej, mas luftës t'njejtat sene i bojshin edhe shqiptarët diqysh, me neve.

Erëmirë Krasniqi: Për qat' arsye t'veta, prej dy kulturave jo shumë tolerante.

Bajram Kafu Kinolli: Unë isha me shqiptarë, kur u kry lufta, krejt e kthynë trakën tjetër. Po, nuk m'ka bo qajo m'u frigu, jom konë tona herë, e dojsha njeri shkollën, se e dijsa që pa shkollë nuk munesh kurgjo me bo. E dijsa që pa shku n'shkollë me njoftë shoqni, pa msu sene të tjera, nuk munesh me bo kurgjo. Jom konë nashta n'shkollë t'mesme njo prej dhetë fëmive nxanësa romë që ka fillu ma s'parti me shku n'shkollë. Edhe jom regjistru n'gjimnaz, n'tri shkolla jom regjistru menihere, se jonë konë datat t'ndryshme. Dojsa me e provu ku jom, se s'dijsa ku jom. Faktikisht, qatëhere kur jom regjistru, para se me u regjistru m'pat vdekë baba, isha ashtu kejt... s'dijsa çka o ka ndodhë, diqysh *teenager*, s'dijsa çka o ka ndodhë. Knej isha magjup, jo s'ki... "Ku po shkon ti?" T'nalshin rrugës ta hijshin naj shuplakë palidhje, "Qit pare s'a ki prej xhepit!" Ose e pijsha cigaren, t'i merrshin cigaret e fundit. Diqysh o konë *ugly, very ugly* [e shëmtuar, shumë e shëmtuar] diqysh.

Po prapë se prapë, s'e di o njeri, e gjejsha qat' energji që thojsha, "Ej, nëse ata bojnë qështu, *it's their problem* [është problemi i tyre], këta kanë problem, une s'kom problem. Une s'kom bo kurgjo, *this is their problem* [ky është problemi i tyre]." Edhe shkojsa n'shkollë, sa herë, po menojo o konë bajegi shumë problem, po, sjellja e profesorëve o konë shumë njeri, shumë uhhh (psherëtinë) mas luftës, *extremely* o konë shumë keq. S'e di a kom pasë naj profesor t'gjuhës shqipe, profesor magjistër i shkencës t'gjuhës dhe letërsisë shqipe, nashta për qato edhe nuk e di gjuhën shqipe. Edhe n'shkollë fillore e kom pasë shumë...

Erëmirë Krasniqi: As une nuk e di qaq mirë (qeshë).

Bajram Kafu Kinolli: Edhe, (qeshë) ai u konë i burgosun politik, deri në '97-tën, u konë nja pesë vjet n'burg, u konë shizofren. E thirrsha Milosh, o njeri ato, thjeshtë e thirrsha Millosh. Qaq o konë... qasi ftyre e ka pasë, qasi frizure e ka pasë, qasi karakteri që... nuk e di, o konë shumë i keq me mu, tonë kohën o konë shumë i keq.

Erëmirë Krasniqi: E përmende që jonë gjashtë mahalla rome. A ka pasë aty naj komunikim?

Bajram Kafu Kinolli: Uhhh... kqyre.

² Serbisht: *izbeglice*, refugjat.

Erëmirë Krasniqi: Për me përballu krejt këtë farë presioni.

Bajram Kafu Kinolli: Une, kqyre... s'po di, s'po muj me e bo këtë lidhjen se ka bajegi shumë sene, po m'bijnë ashtu n'kokë. Ka pasë ma shumë se gjashtë mahalla rome para luftës.

Erëmirë Krasniqi: A na kallxon historinë e tyre?

Bajram Kafu Kinolli: Ka pasë ma shumë. Njo o konë bashkangjitë me rrugën e serbëve, o konë, njo o konë qitu poshtë që s'di ku jonë mas luftës, s'di thjeshtë ku jonë. Ka pasë shumë ofensiva, ksi, UÇK e ku ta di une, po thjeshtë kisha pasë qef me ditë ku jonë. I kom pasë do shokë edhe kurrë s'di ku jonë diqysh edhe kurrë s'i kom gjetë, najhere. Po menoj, aty ka qenë ajo lagje, ka qenë, une e maj n'mend lumin, o konë lagja. Ata jonë konë shumë fukara, jonë konë shumë njerëz t'mirë, punojshin tonë kohën. Edhe mas luftës si u bo çlirimi i Gjakovës, *no one is there* [askush s'është aty]. Kejt o konë... e kallën krejt atyhen, edhe s'dijmë ku jonë diqysh.

Masnej osht' lagjja e Berkocit, osht' i njeiti sen që ka ndodhë. Osht' edhe Piskota³ që ka ndodhë i njeiti sen. Besa edhe n'mahallë t'Sefës kanë ndodhë do sene që bajegi jonë konë do fërrka tre mujë, katër mujët e para që deri sa e ka marrë kontrollën KFOR-i. Na s'kem mujtë me guxu me dalë faktikisht. Për shembull, vllavi i madh pat shku n'Shqipni mas luftës. Pat shku n'Shqipni se ma sigurt atje, baba e çoi anena. Po menoj, o konë shumë n'stës, për babën tem o konë shumë stës. Vijshin njerëz n'shpi, t'hallakatshin pa kurrëfar...

Erëmirë Krasniqi: Pa kurrëfarë autorizimi.

Bajram Kafu Kinolli: Op, *exactly!* [pikërisht] Po menoj për qato edhe baba jem ka përjetu shumë trauma si... E maj n'mend, shumë interesant, n'kohën e '99-shit ishim qitu, para se me u nisë te daja atje, erdhën paramilitarët, dy metra t'mëdhej njeri, krejt gjak ishin, n'gjak ishin me thika n'dorë qështu ishin edhe po na bojnë, "*Jel ima iptari ovde?*" [A ka shqiptarë këtu?] Tash, baba jem nuk e dike serbishten, nana jem e dike serbishten se ajo e Mitrovicës u konë, e ka pasë serbishten ma asi, edhe po del mama jem përpara diqysh. Ky baba jem u nxi, qaq shumë u nxi, qëtash krejt fëmija ishim n'oborr, na ishim t'u hongër faktikisht bukë, "*Jel ima iptari?*" Pesë veta o njeri, ku t'hijnë pesë veta. Qajo dera që osht' qashtu, e ulshin krytë o njeri, qaq jonë konë t'mëdhaj, hinën, "*Jel ima iptari ovde?*" Mama po ia bon, "Nuk ka shqiptarë këtu" a din qysh.

Erëmirë Krasniqi: Në '98-tën a '99?

Bajram Kafu Kinolli: Në '99-tën bombardimet. U konë... e maj si sot n'mend, prill o konë, o konë bash muji i pari si ia kanë nisë... qajo. Edhe tash, tha, "Kush po jeton knena?" Ky kojshia {tregon me gisht kah shpija}, ky kojshia ma heret pat shku, patën ikë prej ktuhit, nuk e di ku kanë shku, masanej e di që jonë konë n'Shipni. Tha, "Kush osht' knena?" Qysh me ditë na, mama po ia bon, "Qysh me

³ Mahallë në Gjakovë. Sot njihem me emrin Dardania.

ditë na.” Tha, “Hajde kapërce zidin!” Po ia bon mamës me kapërcy zidin. Tha, “Qysh me kapërcy zidin?” Tha, “Hajde, ama djalini!” M’kanë kapë mu qështu njeri {tregon me duar}, n’qit zidin komplet.

Erëmirë Krasniqi: Me kontrollu ti [nëse kojshit janë aty]?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, jo, me shku me ia çelë derën une atynve që ata mos m’u lodhë. Qështu m’kanë kapë {tregon me duar}, m’kanë gjujtë. Edhe po ia çeli derën, diqysh s’ki çka bon n’atë moment. Tash ishin n’kontrollë ata, tonë kohën ishin n’kontrollë. Ishin përmi një qind veta paramilitarë, ishin te rruga aty, e kishin kallë *ro tiljin*⁴ t’u hongër, t’u pi, t’u knu, t’u... a din qysh. Edhe na ishim bash n’fillim t’rrugës, tash na nuk e dijsim çka ka me ndodhë me neve a p’e din diqysh.

Erëmirë Krasniqi: A po na kallxon qysh osht’ struktura e mahallës t’jujë?

Bajram Kafu Kinolli: Po, struktura e mahallës tonë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë.

Bajram Kafu Kinolli: Po ka qenë, qikjo lagja, po menoj “Sali Morina” qitash e ka emrin, përpara krejt rruga, kjo rruga tash thirret “Fehmi Agani” kjo kryesorja, rrugica osht’ “Sali Morina” përpara o konë “Miloš Obilić”. Kjo rruga këtu {tregon me gisht} ka qenë shumë e përzime, jonë tri-katër familje me mbiemër tonë që i kemi kusheri, domethonë qikjo shpija e tij ka qenë e jonja faktikisht, o konë toka e jonë, po e kemi shitë, po menoj gjyshi e ka shitë atëhere n’fillim se i pat martu djemtë (qeshë). E knej n’kit anën tjetër o konë ni boshnjak, ka pasë romë, romë prapë, shqiptarë, prapë o konë e familjes tonë, ka pasë shqiptarë, shqiptarë, shqiptarë edhe o konë prapë një e familjes tonë. Kjo ana tjetër o konë krejt shqiptarë ka pasë, një o konë e përzime shqiptarë me serbë edhe boshnjakë, hala jonë këtu faktikisht, këtu jonë. Edhe osht’ shumë interesant, në ’97-shin, se faktikisht rrethinat e Gjakovës kanë ardhë shumë n’Gjakovë edhe kena pasë shumë asi refugjatë që kemi majtë n’mahallë, tonë kohën jonë konë këtu. E qikjo struktura jonë që o konë masi jonë përzi pak me t’katunit, Kërlanit, o përzi me Mehës e ku ta di unë, kanë ardhë shumë njerëz pleq, amo jo t’rijtë, zakonisht diqysh ata t’rijtë jonë konë nëpër UÇK, a najsën tjetër a ku ta di unë, s’di, po ma merr menja, masnena kur jonë kthy jonë konë djemtë këtu.

Erëmirë Krasniqi: Çka ju ndodhi ktyne kojshive t’jujë qatëherë?

Bajram Kafu Kinolli: Ikën ata, po, ikën, krejt komplet ikën, se erdhën policia, erdhën policia edhe thojshin, sa e maj n’men si sot, nata, e jemi konë qitu {tregon dhomën ku po xhirohet intervista} se na s’e kemi pasë atë shpinë e re, na kemi jetu krejt qitu. Na kemi jetu, unë kom nejtë qitu deri me 14 vjet, kom flejtë. Krejt familja kemi flejtë me ni dhomë, se s’kemi pasë, o konë shumë kohë e

⁴ Serbisht: *ro tilj*, ushqim në skarë.

vështirë. Edhe e maj n'mend, qitu u konë televizioni naltë {dëfton kah një anë e dhomës}, edhe kur fillunë me tregu prej që kanë ardhë n'atë kohë, e qitën atë kangën që zakonisht e kom hala n'tru, atë kangën e ushtrisë serbe që e promovojshin edhe e qitën që n'ora tetë [kur] fillonin bombardimet, diqysh. Edhe kjo mahalla ma poshtë {dëfton kah dritarja} qëtu o konë ni gjeneral kryesor i ushtrisë këtu. Nuk e di çka ka ndodhë me to, kurrë s'e di, po aty u konë gjenerali, e di shumë mirë, e kom pasë shok atë djalë e vet, lujshim basketboll.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë aktiv ai?

Bajram Kafu Kinolli: {Pohon me kokë} Po, menoq që ka qenë aktiv, ai o konë tonë kohën, ashtu gjeneral i veshun me kerr t'mirë, tonë kohën ashtu. Edhe o konë, do prej familjes t'tijna faktikisht jonë konë do mangupa shumë t'kqijë para luftës. Për shembull, ka pasë qasi n'mahallë teme që jonë konë mangupa shumë t'kqijë, ksi jonë konë ekstrem asi huligana, thjeshtë qel, t'mëdhajë me trenerka, tonë kohën jonë konë ashtu...

Mahalla o konë bajegi shumë e përzime tonë kohën, serbë, shqiptarë, romë, boshnjakë, goranë ku ta di une, ka pasë bajegi shumë... Mahalla, po menoq kjo mahalla o qujtë "mahalla e cullakëve".

Erëmirë Krasniqi: Pse, qysh?

Bajram Kafu Kinolli: Se "mahalla e cullakëve" e kanë qujtë, se i ka pasë zidat e ulët edhe për qato i kanë thonë "mahalla e cullakëve". Domethonë, na i kemi pasë, për shkak t'stilit që o konë në kohën e... s'po di '80-tat ia ka nisë m'u kanë ato mrezhat⁵ e hekrit me u bo, diqysh ma asi. Edhe e vetmja mahallë që ia ka nisë, o konë qikjo n'Gjakovë edhe i kanë thonë, "mahalla e cullakëve". Jo, pse jonë dalë gjinja cullakë, zakonisht që e kanë atë tripin.

Erëmirë Krasniqi: Me qenë ma transparent (qeshë).

Bajram Kafu Kinolli: Shumë ma transparent jemi konë, po menoq edhe noshta pse i kemi pasë serbët, që jonë konë n'qasi, a p'e din kur ta sheh...

Erëmirë Krasniqi: T'njejtë...

Bajram Kafu Kinolli: Po de, shihet, kur e ki kojshinë që s'ia ninë, edhe ti bohesh qashtu diqysh. E sheh rrushi rrushin e piqet, kajhere qështu thojnë te na n'Gjakovë (buzëqeshë). Eh, m'u kthy te ajo pjesa e policisë, çka ndodhi deri qaty, o konë... mas ni kohe erdhën prapë masi iu çela derën, erdhën prapë me lypë krypë se ishin t'u hongër ata, kishin *ro tilj*, kishin marrë lopë t'u pre ku ta di une diqysh. Çka kishin bo ata, une s'di, na s'dijshim, veç e nijshim që osht' *ro tilji* qaty se u nijke era, u nijshin krejt senet. Edhe erdhën murrën krypë, tha, "Ju, edhe pak ditë, s'kem me ju lonë gjallë." A

⁵ Serbisht: *mre a*, rrjetë.

p’e din qysh, se ata veç ishin pi diqysh, ata... me ju pa sytë atyne o konë shumë interesant, o konë shumë... çuditshëm jonë konë. O konë s’e di si t’egër u dokshin a p’e din qysh.

Erëmirë Krasniqi: Çnjerëzorë?

Bajram Kafu Kinolli: Op, shumë çnjerëzor, shumë jonë të çnjerëzumë. S’jonë konë t’Kosovës ata, se mama ma vonë na kallxojke që e kanë pasë theksin, jo t’Kosovës. S’jonë konë serbë t’Kosovës, serbët e Kosovës kanë folë krejt ndryshe, e s’jonë konë t’Kosovës. E çka ndodhi atë natë, u largunë o njeri diqysh, kurgjo s’ka ndodhë për fat t’mirë. Po, na mas sa ditëve, o konë ofensivë tjetër. Ishin do pjesë aty ku vijshin policia, policia rregullore, policia me t’kaltërt që jonë konë, me ksi *zastava*⁶, me *zastava* 101-she kur vijshin ata. Jonë konë do kojshi që jonë konë pak ma naltë anena kah stacioni i autobusave. Kur vijshin ata, vijshin me t’paralajmru çka ka me ndodhë sonte për shembull, se jo veç neve, po i kallxojshin krejt mahallës. I kallxojshin prej fillimit edhe ai o dashtë krejve me ia përcjellë.

E për shembull, mas dy netë që ndodhi, mas dy netë pauzë, që ke shumë pauzë, edhe po meno, mas pauzës që kërsoi shumë e madhe, që i hinën krejt asaj mahallës poshtë ku u mytën 29 veta, profesoreshën e muzikës ma kanë mytë qaty, ma kanë mytë çikën e klasës qaty, veç ni djalë ka pshtu.

Erëmirë Krasniqi: Cila mahallë?

Bajram Kafu Kinolli: Osht’ mahalla “Miloš Obilić” qitu, osht’ shumë afër s’i ka as pesë qind metra, edhe na ishim shtu faktikisht. Edhe po vijnë policia shumë vonë, po nihen që po kallen shpiat, diqysh u nijshin, kërsoitshin druajtë, kërsoitshin xhamat, kërsoitshin... u nijshin piskamat, u nijshin gjujtjet, a din o konë shumë ekstrem. Knej bombardojke NATO, ata si bombardojshin, këta gjujshin që mos me u dallu ajo zhurma që çka o ka ndodhë n’qat formë. Diqysh, u konë shumë keq, po s’kanë kallë faktikisht afër qasaj... ku kanë mytë njerëz nuk kanë kallë ata. Edhe masnena erdhën qata policia, u duhtëm, ata thanë, “Nesër n’mëngjes duheni me u largu prej ktuhit.” Tash ka metë, o konë qikjo lagja, o konë lagja përballë, jonë konë kejt edhe lagjet anej ma naltë.

Erëmirë Krasniqi: A u zhvendosët krejt?

Bajram Kafu Kinolli: U zhvendosëm krejt komplet prej ktuhit.

Erëmirë Krasniqi: E serbët, e boshnjakët.

Bajram Kafu Kinolli: Jo, serbët kanë nejtë, serbët kanë nejtë këtu. Ka nejtë edhe ni shqiptar atje poshtë n’mahallë te na.

⁶ *Zastava 101*, brend jugosllav i veturave, përdorej nga policia e asaj kohe.

Erëmirë Krasniqi: A munesh me na përshkru rolin e tyne përgjatë luftës... jo menjihërë, po përdërisa i tregon storiet tjera me e përfshi edhe qat' aspekt.

Bajram Kafu Kinolli: Roli i tynve s' o konë diçka najsen i randësishëm. Kqyre na, a din osht' shumë interesant në '96 deri në '98 ka hupë ai kojshillaku masnej, se filloi urrejtja, filloi "ti je me kto, ti je me ato, ti je me kto, ti je me ato; ti je kështu, ti je ashtu, ti je kështu". Erdhën refugjatë, masnej prej refugjatëve filloi krejt ajo me konë... filloi me u bo ndamja. Unë s' e kuptojsha, na jemi konë shumë, unë jom konë shumë i vogël, po kur e kqyri qysh ka fillu, jo "Qysh ma nguci djaln" masnej u bajshin fjalët që i kemi pasë boshnjakët që jonë konë pak... se kanë ditë serbisht. Këta refugjatët u tutshin prej tyne se menojshin që janë serbë. Po diqysh ata nuk kishin vetëdije kush jonë boshnjakët faktikisht, se jonë ardhë prej katuneve, garant s' kanë pa, s' kanë ni kurrë për boshnjakë. Jonë konë asi malësorë, ose najsen a p' e din qysh. Edhe tonë kohën kur ishim, kur lujshim bashkë, osht' shumë interesant, i kemi pasë qit livadhin n' krye t' rrugës qaty, s' ka pasë kurgjo, s' ka pasë livadh edhe qaty lujshim futboll. Edhe nuk u ndajshim na se si mahallë, si fëmi nuk e dijsim çka o ka ndodhë diqysh. Osht' shumë interesant...

Erëmirë Krasniqi: Po, politika nuk ka lujt rol në mahallë.

Bajram Kafu Kinolli: Op de, op edhe lujshim bashkë, amo, o konë tonë kohën ai tensioni. Për shembull, kur vijshin serbët, ata merrshin a p' e din qysh pjesën edhe u duhshe me shku n' shpi. Për shembull vëllau jem o pat rrehë me ni djalë t' policit, e pat rrehë shumë edhe erdhën policia n' shpi tash. Se ky vëllau jem o konë shumë mangup kështu si person, s' ia len kërkujna, jo mangup po o konë shumë... osht' [pa kupt.], osht' shumë *comfort*. Edhe erdhën policia, e kanë marrë, "E pse kështu, pse ashtu?" Edhe e kanë rrehë, s' e kanë rrehë shumë se i vogël, s' u konë shumë ashtu i vjetër edhe e kanë lëshu se o shku edhe mama t' u u lutë e t' u kajtë, e ku ta di une.

Po, t' u u kthy te kjo loja këtu, *weird* [çuditshëm], *weird* o njeri, masnej u ndanë ata, u ndamë na kejt, a p' e din qysh, se secili menojke që ka me ia ngulë njoni-tjetrit, që ki me qitë njoni-tjetrit, ose ki me bo shpiunazhë ose asi... o konë qajo ndjenja mrena. Nuk hijshe, nuk delshim mo, nuk hijke, nuk delke kërkush mo, a p' e din qysh, krejt u tutshin. U bojke ora pesë, hijshe mrena, s' ka kurgjo, a pe din qysh. Prej '98-shit o konë qështu, ora pesë, u duhshim me hi mrena.

Erëmirë Krasniqi: Ku shkutë ju kur u afriu rreziku?

Bajram Kafu Kinolli: Na shkumë te Hadi Bajrami, te daja i babës tem. Shkumë atje, u rahatëmë, po o konë qat javë o kallë çarshia e vjetër. E maj si sot n' men që o konë njo prej nateve s' e di a muj... ma t' këqija t' jetës teme. U nijshin prej tri kilometrave zanat e njerëzve njeri, se qaq qetësi n' ora katër, ora katër e mëngjesit.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë shpija përmbi Çarshi?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, osht', po meno, kjo pjesa e çarshisë osht' pak ma naltë se osht' kah ana e Çabratit aty edhe na, mahalla e Sefës osht' në nivel pak ma t'ulët. Edhe qetësia e madhe, t'u mos pasë njerëz n'Gjakovë shumë, u nijshin shpijat t'u u kallë, u nijshin njerëzit t'u kajtë, u nijshin pushkat, u nijshin... A di, o konë shumë ekstrem. U shihke drita që u kallke diçka qanena, po s'e dijmë çka o kah kallët, e qajo o konë nata shumë ma e keqe. Qajo edhe ajo kur teqen që e kanë kallë, që kanë mytë n'teqe, n'teqen e madhe n'Gjakovë këtu, që i kanë mytë plot burra. E krejt ma vonë i kom marrë diqysh vesh çka ka ndodhë. Mas luftës i kom marrë vesh. Une n'çarshi t'vjetër deri në 2002, nuk kom hi n'çarshi t'vjetër, se o konë shumë vështirë me hi n'çarshi t'vjetër, se jonë konë njerëzit shumë t'frustrumë anena. Me t'pa magjupë, me kalu anena o konë shumë vështirë. Diqysh jonë konë disa kanale që mujshe me kalu si romë mas luftës.

Erëmirë Krasniqi: Kallxom qysh e përdorshit qytetin ju, kallxom pak, qysh qarkullojshit nëpër qytet?

Bajram Kafu Kinolli: O konë qendra, prej stacionit fillon në dy rrethe kah erdhëm qetash. Qiknej osht' qendra për me hangër bukë edhe kah shkumë osht' nifar lloj qendre. Tash te rrethi i parë, kur t'kthehesh, jo kah u kthymë kah naltë kah shkumë n'shpi, po, me u kthy anej {shpjegon me duar}, osht' tranziti i Gjakovës, osht' nifar tranziti. Na u duhshim për m'i ra qanena ktyneherë për me shku n'mahallë, po për me shku n'mahallë t'Sefës për shembull, qajo o konë për me shku në *safe security* [vend të sigurtë] ashtu m'u konë, qanej u duhke me i ra. S'po di o njeri... osht'... kjo osht' periudha mas luftës, e para luftës jonë do sene tjera, ngjarje që... mas asaj që ndodhi që u kallë çarshia e vjetër, na metëm pa mill, millin e kishim këtu, se gatujmë, tash hala gatujmë. Metëm pa mill, tash unë isha i vogël, e kishim atë kolicën me tre rrota. E morrëm kolicën une e mama edhe erdhëm deri n'shpi për me marrë millin. Edhe o konë nashta ora ma... une kom pa njerëz t'dekun n'rrugë, kom pa... shumë keq o konë, shumë keq o konë, gjak. S'e di... të këputne komë, dorë, o konë ekstrem shumë keq deri sa kemi mrri n'shpi. Deri... o konë shumë keq.

Erëmirë Krasniqi: Po e bajmë një pauzë.

Pjesa e Dytë

Bajram Kafu Kinolli: Mama kajke shumë, diqysh s'dijsha çka me bo, o konë shumë [në] shok, jom konë shumë në shok. E maj si sot n'men, menxi s'e merrshim frymë, t'u ecë vijke era shumë e keqe prej shpijave t'kallne, prej... vijke era njeri i kallun, o njeri, ashtu taman, bukalisht. Edhe e kemi... qikjo rruga "Femi Agani" që o qijtë, "Miloš Obilić", i ka përafërsisht një kilometër e katër qind metra, 1.4 diçka qashtu o konë krejt qajo rruga. Jonë konë do shpija t'kallne, do s'jonë konë t'kallne, po qajo shpija, qaty kanë ndodhë krejt vrasjet, jonë konë krejt nëpër rrugë. Njerëz ka pasë, s'e di sa jonë konë, veç e di që i kom pa një katër-pesë veta që jonë konë n'rrugë t'shtrinë n'tokë.

Erëmirë Krasniqi: A i njihshe?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, jonë konë t'kthytë kështu, ku ta di une. Garant jonë konë prej lagjeve të tjera që kanë ikë ose najsen. Asnjo s'mujsh as me i kqyrë o njeri diqysh, ku me i afu o njeri qysh osht'. Veç u munojshe me ecë, munojshe me ecë sa ma shumë, me ia fillu edhe me ngajtë faktikisht. Tash nuk dijsim a me shku mrapa, a me shku përpara, se s'dijshe kah po t'vjen mo diqysh. Mrrijmë n'shpi, mama u ulë t'u marrë frymë, i lavi faqet, m'i lavi mu faqet, tha, "Krejt kjo osht' kaluse" ma bojke, "kjo krejt osht' kaluse, s'ki nevojë me menu ashtu". Se tash ajo, si mamë hijke n'atë...

Erëmirë Krasniqi: Obligimin prindor...

Bajram Kafu Kinolli: Obligimin e... po veç n'qat moment kur u ulëm me pushu, erdhën tre shqiptarë. Nuk e di, veç kanë kcy prej zidave, veç jonë ardhë e kanë kcy prej... n'oborr qitu. "Kah me ikë? Kah me ikë?" Na bojshin, "Kah me ikë?" Veç p'e nijmë na shumë zhurmë e madhe e kerreve t'u ardhë, që jonë konë policia speciale. Shumë zhurmë e madhe o konë, muj me thonë dhetë sekonda që s'na kanë pa bashkë, se t'na kishin pa bashkë, ishim shku edhe na. Kur jonë hi mrena, bash te na jonë hi mrena, ata kanë kalu, qikjo pjesa përmapa qitu, kanë kalu zidat anena, nuk e di çka kanë bo ata njerëz mo. Edhe na kanë vetë, "Ku metën ata? Ku metën ata?" po menoj mamës, "Gde su oni? Gde su oni?" [Ku janë ata?] "Jel ste ih videli? Jel ste videli albanci? Jel ste videli iptari⁷? Gde ste videli iptari?" [A i keni pa? A i keni pa shqiptarët? A i keni pa iptari? Ku i keni pa iptari?] Mama thojke, "Jo, s'kom pa", kajke tash se ish ai momenti... edhe tash ata po na pysin, "Kush jeni ju? Pse keni ardhë këtu? Çka po boni këtu?" Diqysh, tash mama po ia spjeron që osht' shpia jonë, jemi ardhë me marrë mill. "Pse po rreni? Jeni ardhë me vjedhë", kështu atëhere mama e ka marrë ni fotografi t'veten që, "Qikjo osht' fotografia jeme, kjo osht' shpia jeme" diqysh. "Ku i keni shqiptarët?" i bërtitke tonë kohën mamës, na kanë majtë qaty gjysë ore ashtu t'u e pytë mamën teme. Nuk bojshin najsen fizik, po veç jonë konë shumë agresivë.

Masnena, shkunë ata, zhdrypëm na n'podrum bashkë, se n'podrum e kemi pasë, osht' qiky podrumi qitu. E kemi pasë shpinë jo t'marume krejt, po e kemi pasë kështu n'tulla, pjesërisht e marume n'podrum. Dy thasë mill i kemi qitë, prapë kemi kalu nëpër qat gjak o njeri, nëpër krejt senet. S'di une s'e maj mo n'mend, prej se që jom dalë prej mahallës, prej lagjes teme, s'maj mo n'mend kurgjo se jom konë n'shok.

Erëmirë Krasniqi: Pse nuk mendojshit me ikë, apo ishte shumë rrezik?

Bajram Kafu Kinolli: O konë shumë rrezik përderisa na lëvizëm n'atë mahallën tjetër se ata vijshin e i regjistrojshin njerëzit kush jonë këtu që me ditë kush osht' t'u shku, çka osht' t'u u bo, kush janë,

⁷ *iptari*, term nënçmues për Shqiptarët e Kosovës, e përdorur nga Serbët për të krijuar dallimin nga Shqipëtarët e Shqipërisë.

tek janë. Faktikisht, kanë japë edhe libreza ata, që m'u konë kishe t'regjisistrumë aty, si letërnjoftim ose ku ta di une.

Edhe qajo, po menoj, mas dy jave, tri, osht' qetësu pak situata, i kanë pastru këta njerëz. E maj shumë n'mend mirë që i merrshin... zakonisht këta romët kanë punu shumë puna t'vështira për shembull. E kanë pasë, zakonisht romët e kanë pasë punën me e mbledhë bërlllogun me asi kamiona, a ku ta di une. Edhe tonë kohën vijshin, për shembull n'lagjen e mahallës t'Sefës, e merrshin kon ta gjejshin rrugës, naj djalë ose najsen.

Erëmirë Krasniqi: I punësojshin?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, jo i merrshin kështu, n'kamion i hypshin edhe i çojshin me pastru, me i hekë t'deknit, ose me i vorrosë ose ku ta di une, kanë ndodhë qësi sene. Edhe sigurisht që jonë do prej qatyne nuk jonë këtu, asnjë nuk janë këtu faktikisht, do edhe i kanë mytë qashtu faktikisht. I kanë çu edhe s'i kanë kthy mo. Edhe sigurisht që janë do prej qatyne që e dijnë ku janë disa prej trupave t'pagjetuna. Unë e besoj që do nashta e dijnë, nashta edhe s'guxojnë me folë faktikisht, nashta edhe s'jonë këtu, nashta edhe i kanë mytë diqysh qata që dijnë.

E qaty u bojke krejt biznesi, u shitshin cigaret, u shitshin sene, n'qat lagjen e Sefës, nuk osht' veç lagja e romëve. Ka, nja dy lagje ma poshtë jonë krejt shqiptarë që romët tonë kohën jonë munu me i mbrojtë shqiptarët.

Erëmirë Krasniqi: Pse, në çfarë pozicioni ishin romët gjatë luftës që me mujt me i mbrojt shqiptarët?

Bajram Kafu Kinolli: Po ishim n'atë pozicionin që "okej, neve s'po na prekin", i kishin tash ato linjat që policët, ata përpara, policët lokalë na rujshin neve edhe plus ushtarët. Tash ata nuk i kallxojshin që ka shqiptarë aty faktikisht, po diqysh, "A ka shqiptarë?" Si t'hijsin kontrolla, e kishin atë linjën e shpisë faktikisht që ose i çojke naj fëmi a najsen me lajmru që... ose naj signal që, "Hypni n'tavan, se kur t'vijne, mos t'ju gjojnë këtu n'shpi." Ka pasë qësi sene që kanë ndodhë.

O konë ni sen tjetër që e maj n'mend qat periudhë, e kom pasë ni arsimtare t'edukatës qytetare, emrin ia kom harru. Edhe po kaloj... ish tash, u qetësu pak situata, ish një dyqan që u thirrke "Dushkaja". Vëllavi jem u punësu aty faktikisht, n'kohë t'luftës, u punësu se s'kishim çka me hongër, s'kishim çka me pi diqysh. U sos milli, u sos krejt senet, vëllavi shkoi n'qat magazinë edhe lypi punë, që bilëm me marrë për çdo ditë naj ushqim ose ku ta di une, i madhi. Edhe ato e majke nifar shefi, komandanti, ku ta di une, shumë i madh. Ai s'jepke pare kurrë, a p'e din qysh, a t'jepke, a s'të jepke naj natë me hongër. U duhshe tonë kohën me punu aty. Edhe shkova tash une me marrë, zakonisht u dufke me shku n'ora tetë me shku me marrë, i kishe... që ia jepke vëllait tem katër bukë, na ishim tetë veta, katër bukë, dy litra qumësht edhe qaq.

Edhe n'ora tetë, tash une kalova nëpër mahallën e Sefës që kanë jetu edhe do shqiptarë. Jonë konë do shpia aty, jonë konë shumë t'mira edhe po m'sheh profesoresha. Unë s'e kom ditë që osht' profesoresha aty. Diqysh po ma bon me dorë prej dritares, "Bajram, Bajram!" Po kthehna, "Kush po m'thirrë"? edhe p'e kthej krytë, p'e shoh profesreshën. Po ma kthen, "A munesh bre me ma ble edhe dy litra tamël mu? Qe po t'i jap paret." A din qysh, ti mujshe me ble aty. Une, "Po, po shkoj." Ma s'parti m'veti, faktikisht se po m'kapërcen ashtu, veç po munohna me kallxu... (psherëtinë). Edhe po shkoj, p'i ia blej dy litra ma tepër profesreshës. P'ia çoj, po m'puthë, po m'shtin mrena, po m'përqafë, "A jeni mirë krejt?" Po m'vetë tonë kohën, "Qysh s'po tutesh me dalë?" Diqysh... edhe kur e kalon me ni fazë edhe pse isha 14 vjet, mo nuk kisha tutë diqysh, msohet njeri për dy mujë ditë, kur e ki për çdo ditë, për dy mujë ditë qat sen, s'ki...

Tash shpia e dajës, ku ish qaty, e kishim vijë ajrore, SUP⁸-i kryesor i Gjakovës, që o konë e reja, "SUP-i i Ri" që i thojshin, aty ku i rrehshin njerëzit ma shumë që o konë podrumi shtatë kat, m'doket, sa e di une. Qaty, domethonë, vija ajrore e kemi pasë, s'e di as një qind metra s'o konë. Edhe qaty...

Erëmirë Krasniqi: A kanë bombardu?

Bajram Kafu Kinolli: Edhe qaty, bombardojshin për çdo *fucking* ditë, deri sa u ça shpia e dajës, diqysh, qaty ishim o njeri. Bombardojke për çdo ditë, a din qysh, për çdo ditë bombardojke. O konë shumë interesant masnej ma vonë me i konceptu senet, qysh ti munesh me e bombradu ni sen që osht' krejt lagja t'u jetu, a pe din qysh. Osht' hapësinë e publike, a p'e din qysh, osht'... jonë njerëzt t'u jetu aty, a s'pe din që jonë njerëzt aty? O konë shumë interesant ajo.

Erëmirë Krasniqi: Prej NATO-së jonë bombardu?

Bajram Kafu Kinolli: Prej NATO-së jonë bombradu.

Erëmirë Krasniqi: A e huqke najhere, a jo?

Bajram Kafu Kinolli: Po qysh, ka huqë, ka ra pak ma anena. Osht' ni tyrbe aty, Tyrbja e Babës Çetë që i thojnë, qaty ka ra n'oborr. Qaty o konë banesa, gjinja kanë jetu aty n'banesë, jonë konë shqiptarë n'banesa. O konë shumë tmerr me e pa ato çdo ditë t'u u bombardu, diqysh... okej e bombardon dy-tri ditë diqysh, ajo o konë e shkatërrume, po prapë bombardojshin o njeri, si me gjujtë bomba për me i hargju [kot] o konë.

Erëmirë Krasniqi: Noshta për shkak të podrumëve, kateve që jonë konë nër?

⁸ Serbisht: *Sekretariat Unutra njih Poslova (SUP)*, Sekretariati i Punëve të Brendshme.

Bajram Kafu Kinolli: Po kur shembet krejt ti s'ki qysh del. A p'e din qysh o konë... *obvious* [ashiqare].

Erëmirë Krasniqi: *General madness* [Çmendi e përgjithshme].

Bajram Kafu Kinolli: A p'e din qysh... ni javë ditë me e bombardu ni ndërtesë që i ka 40 me 50, a p'e din qysh, o konë shumë abnormale ka dhetë- pesëmdhetë bomba n'ditë, diqysh.

Erëmirë Krasniqi: A ju lajmrojshin mo sirenat?

Bajram Kafu Kinolli: Çfarë sirenat, s'punojshin mo sirenat, a p'e din qysh... s'kish as rrymë kanihere. S'kish rrymë, diqysh, s'ka pasë rrymë n'atë kohë. Kish rrymë ashtu kah ni orë, dy orë që vijke se e nalshin rrymën që puna mos me pasë asi...

Erëmirë Krasniqi: A ka ekzistuar najherë, gjatë bombardimeve, a ka ekzistuar ai normaliteti i rrejtshëm ashtu? N'Prishtinë ka ekzistuar qai sen.

Bajram Kafu Kinolli: Po, ka ekzistuar, ka ekzistuar. Qai normaliteti o konë tri javë para se me e u çliru. O konë shumë i rrejtshëm, s'e ki idenë sa i rrejtshëm o konë qai sen. U çlirumë n'atë aspektin mjukshe me lëvizë ma lirë. Nuk ishin paramilitarët, ikën paramilitarët, tash metën ushtria. Ushtria nuk të ngucshin ty se ushtria jonë konë shumë t'rijë. Jonë konë ashtu njerëz t'pafajshëm, s'di... unë kurrë s'kom pa për veti ushtria që e ka nalë dikun, ose e kanë kontrollu, ose najsen kanë bo. E kanë pasë atë pozicionin e vetë, kanë nejtë, për shembull, o konë njo te parku, o konë njo qitu te... garazhat e kamionave, osht' pjesa anena ku u kthynë bash te ajo rruga prej tenaltzës që u kthynë. Qaty faktikisht o konë garazha e autobusave, garazha e kamionave të mëdhaj, nuk e di prej cilës fabrikë. Eh, qaty o konë ajo që rrijshin... ushtarët u ndërroshin, jonë konë tri-katër veta.

Edhe o konë ni... mas qasaj tri jave na u kthymë dy javët e fundit këtu. Edhe erdhëm këtu n'shpi. Vëllavi i madh me grunë nejtë te daja atje, na u kthymë këtu. Serbët ishin hala këtu nëpër shpija t'veta.

Erëmirë Krasniqi: Edhe ju rrisht pak ma...

Bajram Kafu Kinolli: Ma çlirë o konë, shumë ma çlirë, se u nalën faktikisht bombardimet nëpër qendra asi... po kqyrshin ku ka tenka, kesi sene nëpër livadhe. O konë shumë interesant tripi, ni zdrukthtar qitu o konë, afër e kemi n'mahallë, Vraniqi. E shtijshin me maru tenka serbët, prej drunit, t'mëdhaja. Ai plak, njeri, e shtijshin me maru tenka, i bijshin ushtarët me i nihmu, normal me maru tenka edhe i qitshin n'livadh. Kjo o konë kjo pjesa kah lumi, shkojmë e kqyrim që doni {i drejtohet të pranishmëve}. O konë krejt livadh edhe qaty jonë konë romët. I çojshin njo tre kilometra larg, e i qitshin tenkat e drunit edhe NATO veç bombardojke, bum-bum. Krejt palidhje, trika shumë

palidhje, na keshim o njeri, besomë, na keshim se o konë shumë *stupid* [marrëzi]. I shihsha t'u maru tenka, o konë shumë *stupid* ajo.

Masnej u normalizu, shkunë. E kisha une ni shok serb këtu, i kish... osht' ni lagje atje ma poshtë. Edhe kur shkumë, kur shkova për herë t'parë me e taku mas ku ta di une, dy mujë e gjysë gati u bonë. Po shkoj aty n'shpi t'tijna, ai i kish bo njo 50 topa, i kish bo njo 70 biciklla, i kish bo njo... ku ta di, *PlayStation*. Jo *PlayStation*, po *SEGA Mega* që o konë n'atë kohë. *Nintendo* kish bo, shumë sene. Une nuk e kuptojsha atë sen hiç kurrëqysh s'mu lidhke mu, hiç. Edhe po ia boj, "Ku i ke marrë bre?" Tha, "Qe baba m'i ka pru prej magazinës." Qështu ma bojke, "A don me ta falë ni bicikëll?" Ma bojke. Une e kom marrë bicikllën, e kom pru n'shpi, baba m'ka thonë, "Merre bicikllën, çoje bicikllën atje," edhe m'ka dënu bajegi shumë ashtu, s'ëm ka lonë me dalë tri-katër ditë mo jashtë.

U kry lufta! U kry lufta, ikën njeri. Erdhën kamionat, jonë konë përmi 50 kamiona njeri që hijshin nëpër mahalla, ngarkojshin.

Erëmirë Krasniqi: Ngarkojshin prej shpijave?

Bajram Kafu Kinolli: Po, po hijshin ngarkojshin senet prej shpijave. Serbët ngarkojshin krejt çka kanë pasë njerëzit, sene t'çmushme normal, teknika t'bardhë e kto.

Erëmirë Krasniqi: Zyrtarë, njerëz a?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, jo njerëz t'zakonshëm, njerëz t'zakonshëm jonë konë.

Erëmirë Krasniqi: U bartshin edhe vjedhshin sene a?

Bajram Kafu Kinolli: Po, po. Kamionat i mushëshin njeri, plot, plot njeri, plot, plot, plot. S'di une njeri, 50 kamiona diqysh, me i pa 50 kamiona menihere ashtu. Hijshin veç nëpër mahalla, ishin ni qind sene. Na ishim n'rrugë, a p'e din qysh. Na guxojsim me dalë deri te qajo rruga qaty. Si te kalojshe atë rrugën tjetër, ai t'pritke atje, a p'e di qysh. E kishe orarin e caktumë ku munesh me kalu ti n'rrugë, me shku n'qendër, me ble bukë e asi sene, ose t'lejke ai. Vijke merrke naj bukë, s'kish bukë ushtari, masnej t'lejke diqysh, e kishe t'libër me to kur e ngjishhe ushtarin, se dikur edhe i ndërrunë ushtarët faktikisht. Se kur i bojshe shokë, i bijshe bukë ose t'lajmrojke që, "S'guxoni me nejtë sonte këtu, ma mirë shkoni dikah tjetër se kanë me ardhë..." i dike ai informacionet. A din, ka pasë shumë ushtarë t'mirë njeri, s'e ki idenë sa ka pasë ushtarë t'mirë që kanë mbrojtë njerëz, a din qysh. Jonë konë shumë t'rijë, kanë mbrojtë njerëz diqysh, se ata, s'jonë ardhë faktikisht... ata i kanë nxonë lufta.

Nuk e kom njoftu ma shumë, po e di saktësisht, osht' ni person që o konë bashkë n'luftë këtu. Osht' në Serbi, osht' shumë i njoftshëm për mu qitash. Osht' të themi, gati familjarisht lidhem, jo prej grusë, por osht' prej kumarës, ai e ka nxonë lufta n'Gjakovë.

Erëmirë Krasniqi: A po na përshkrunë?

Bajram Kafu Kinolli: Osht'... ai ka, po menoj, osht' Helena njo prej shoqeve t'mia ma t'mirat, osht' edhe kumara jem. Osht' edhe shoqja ma e mirë e grusë, edhe vëllavin e vetë e pat nxonë lufta n'Gjakovë. Edhe i ka do letra shumë interesante, s'po di qysh me ta spjegu ato letra, po osht' noshta qato shkëmbime me vëllaun e vet që i ka pasë. Jonë shumë t'mira, jonë shumë prekëse, jonë shumë sene, s'e di, noshta osht', munesh edhe libër me shkru prej qasaj shkëmbimeve që i kanë pasë. Nuk e di sa osht' e lejushme me e kontaktu atë personin. Ai o martu qitash, e ka ni fëmi, prapë osht' hala me asi... trauma, ku ta di t'luftës.

Erëmirë Krasniqi: A t'ka tregu?

Bajram Kafu Kinolli: Ah jo, une s'e kom taku asnihere ato. Asnihere s'e kom taku se nuk ma jepke me u taku, nuk e di pse. A [me] kit Helenen e kom shumë mirë, e kom shoqe, motër e kom diqysh, thjeshtë, punojmë bashkë e krejt senet. Unë s'muj m'u taku me to se diqysh, m'kapë... nuk e di, m'kapë ajo, s'po di, trauma, hala s'jom i gatshëm me e taku atë person. Nuk osht' që ka bo keq, nuk osht' që ka mytë naj person. M'ka kallxu Helena, nuk ka mytë kur u konë ushtar i thjeshtë, o konë në bllok-post, veç me pritë, e ka kry orarin e vetë, ka ndërru, po kanë hekë shumë. Kanë hekë shumë nëpër shi, kanë hekë shumë nëpër borë, kanë hekë, a p'e di qysh. Kanë hekë shumë për bukë, kah pesë-gjashtë ditë s'kanë hongër bukë besa kanihere, i kanë çu nëpër katund, kanihere me rujtë, a p'e din. Ka qësi storie shumë interesante si mungesa e familjes, mungesa me hangër mish, mungesa me pi ni gotë raki. I ka do përshkrime shumë t'bukura poetike, masnena osht' shumë interesant, ka shumë sene t'mira.

Erëmirë Krasniqi: Ushtria faktikisht nuk ka bo shumë krime, paramilitarët i kanë bo krejt?

Bajram Kafu Kinolli: E në Gjakovë osht', në Gjakovë kanë bo policët e Gjakovës edhe këta që u veshën. Mas luftës jonë konë do huligana, jonë konë do asi... po edhe paramilitarët jonë konë që erdhën. Po ka pasë edhe prej shqiptarëve që kanë bo njeri.

Erëmirë Krasniqi: E kta *skinheads-at*, a u veshën ata?

Bajram Kafu Kinolli: E kta *skinheads-at*, ata shkunë në vene ma t'mëdhaja se...

Erëmirë Krasniqi: Se ambiciet ma t'mdhaja?

Bajram Kafu Kinolli: Normale. E për shembull...

Erëmirë Krasniqi: E qysh kenë shqiptarët?

Bajram Kafu Kinolli: Shqiptarët... shumë osht' interesant. Jonë konë ni familje, osht' bajegi e njoftshme kështu n'Gjakovë, edhe dihet që kanë bo shumë krime. Osht' konë ndër shpiunët më të

mëdhej, osht' Mushë Jakup. E dilke baba edhe djali i vetë, ata e kanë pasë te shkolla jeme shpinë qanena. Edhe jonë konë... tonë kohën dilshin ata me biciklla, me kerre, dilshin shlrë. Ai shqiptari o konë i veshtë me... nuk e di pse e ka pasë t'jeshiltë kostumin. Nuk e kuptoj qat sen. I vetmi ai o konë që e ka pasë t'jeshiltë diqysh. Tash a o konë najsen i madh...

Erëmirë Krasniqi: Si t'gjelbërt, a verdhë?

Bajram Kafu Kinolli: Po jeshil, si e gjelbërt. Ai e ka pasë t'gjelbërt me vija t'bardha e ka pasë këtu {prekë poshtë shpatullës së majtë dhe të djathtë}. Edhe e ka pasë asi kapuqi ashtu, faktikisht n'formë të Titos, qashtu e majke, se e majke si anash zakonisht, ka pasë musteqe, folke shqip. Folshin edhe serbisht super me djalë e vetë ashtu tonë kohën jonë konë, n'kontrolla dilshin tonë kohën. Nuk e di çfarë tripi...

Erëmirë Krasniqi: Punojshin për serbët?

Bajram Kafu Kinolli: Faktikisht jonë konë që kanë punu për serbët. Edhe e di shumë mirë që kanë kallë shumë shpia.

Erëmirë Krasniqi: Të shqiptarëve?

Bajram Kafu Kinolli: Qai, vetë. E di shumë mirë... qai personi ka kallë shumë shpia. Jonë konë faktikisht qatëhere n'rrugë kur i pajsha, e gjujshin, nuk e di nifar seni mrena edhe kërshitke dikah edhe ia niske m'u kallë shpia. O konë nifar... s'po di çka o konë ai seni që e gjujshin mrena. Veç e gjujshin fëp, u kallke shpia, s'ia nijke. Hijshin kontrollojshin, garant gjojshin najsen edhe...

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na tregu qysh kanë qenë t'pozicionumë ata?

Bajram Kafu Kinolli: Shumë osht' konë si Charlie Chaplin o njeri. Ashtu shumë jonë konë skena interesante si me konë *black and white* [bardh dhe zi], kurgjo s'po ndodhë, t'u keshë tonë kohën këta. Babë e bir jonë konë qasi maniaka, une kurrë s'kom pa n'jetë teme. Kur i paramenoj qitash, jonë konë shumë maniaka, hijshin nëpër shpia, merrshin çka t'dojshin, shkojshin. Për çdo ditë e ndërrojshin kerrin, për çdo ditë merrshin naj bicikëll tjetër, për çdo ditë bajshin. A p'e din qysh, tonë kohën bajshin.

Erëmirë Krasniqi: *They we're having a good time* [Kalojshin kohna t'mira] (qeshë).

Bajram Kafu Kinolli: *Exactly!* [Pikërisht]. Po masnej, njonin prej tyne, se ata jonë konë shumë vëllazën, sa e di une e kanë vra, e tjetri ka ikë prej ktuhit.

Pesë ditë, Gjakova krejt u la {fërkon duart}, nuk u dike çka o ka bohet kurgjo, krejt hijnë... dulën shqiptarët, dulën romët, dulën krejt t'u i thy dugojat që kanë metë pa thy, t'u marrë sene se ishin gjinja pa bukë. Ishin gjinja t'untë, ishin... a din kur bohet kaosi si n'çdo qytet, dulën me thy gjinja,

me marrë sene. Dulën me thy atë dugojën e madhe që punojke vëllavi jem, dugoja e vetme n'Gjakovë faktikisht që punojke. Punojke edhe *ito Prometi*⁹ faktikisht. Shkunë me marrë mill, krejt qito sene kanë ndodhë shumë shpejtë për pesë ditë. U la o njeri qyteti krejt, masnej veç kur kanë ardhë njerëzit, UÇK-ja ka ardhë ma s'pari. Kur kanë ardhë UÇK-ja, dulëm me festu n'qendër. Une s'jom konë aty faktikisht, une ku jom konë... jom konë te daja, jom konë atje n'shpi t'u nejtë me dajën tem. Veç e di që o konë vëllai jem i madhi aty, e sene, e di që s'e kanë lonë mo me hi n'punë që me festu që u çlirimë, se na u nijshim si pjesë që e çlirimë. Po faktikisht ata s'e kanë lonë, "Kush jeni ju? Shkoni se po ju vramë!" Se krejt me kallasha ata, tash dulën me kallasha. Dulën ata që jonë mshefë nëpër kulma, ose që kanë nejtë në Çabrat ose jonë ardhë prej ku ta di une... nuk di kah jonë dalë ata njerëz, a din qysh. S'di kah jonë mshefë ata njerëz, a p'e din qysh. Ka pasë, po s'di ku i murrën qato armë, s'di ku i murrën.

Edhe... filloi me ardhë NATO, po NATO nuk ish... nuk... ish shumë pavetëdije, ish shumë ashtu... rrijshin [në] kamiona, *pinzgauera*,¹⁰ rrijshin në tenka edhe kurgjo s'ndodhke prej NATO-së, a p'e din qysh. Ata e kishin planin veç ku m'u vendosë. Tash *kasarnja*¹¹ që osht' qaty te stacioni i autobusave që ka qenë park ma heret, qaty ata e murrën *kasarnën* faktikisht. Po derisa kanë hi mrena, se kanë menu që ka mina, kanë menu... po menoj garant edhe ka pasë, ku me ditë çka kanë bo. Ajo *kasarne* s'po di qysh o konë mrena, kurrë s'e di. Edhe, o bo ni kaos shumë i madh, u veshën krejt ata mangupat e Gjakovës që jonë konë përpara, për shembull jonë konë do që kanë shitë cigare ma heret. Une i njoh shumë mirë si... kom shitë cigare njeri, kom shitë prej '96 deri në '98 kom shitë cigare rrugës, edhe i njoh shumë mirë kush jonë konë. Kanë shitë cigare me mu diqysh, jonë konë ashtu noshta dy-tri vjet ma t'vjetër se une. Edhe u veshën... u bonë UÇK fill, a p'e din qysh, u bonë kejt, e murrën n'dorë. Shkojshin, i hijshin edhe shqiptarëve me plaqkitë e ksi sene, ka pasë qësi sene, qësi sene ka pasë që ndodhke.

Kjo shpia këtu {tregon me gisht mrapa}, osht' shpia e gjyshit tem që ka nejtë halla jem që osht' e smutë prej epilepsisë, o konë me gjyshen teme. Gjyshja jem para paralizimit, qe ni vjet gati, qashtu i ka, e këtu ishim krejt, erdhëm n'shpi. A p'e din qysh, tash e nijshim na që n'mahallë t'Sefës tensioni ia nisi m'u rritë. Ia nisën shqiptarët me ardhë t'veshun ashtu me kerre, t'u ia marrë kerret romëve që i kanë pasë n'shpi. T'u i marrë paret, t'u i dhunu, t'u... a din qysh, bojshin asi sene si me m'u konë bisha, ashtu prej hakmarrjes, prej mllëfit, tash, "Jo, ju jeni konë me shkije. Jo, ju duheni me dalë prej ktuhshit!" Dojshin me ta marrë shpijën. Hijshin t'i merrshin senet e tua n'shpi. Knej hala nuk ndodhi kurgjo, knej e murrë UN-i këtë lagjen, se 29 veta hala ishin aty, se e kallën shpijën [deri] n'marim masnena. U kallë shpija, kur u nisën e kallën shpijën ata. UN-i e ka mshelë dhetë ditë komplet lagjen. Vijshin na merrshin n'pytje, "A keni dëgju?" Tona herë i kallxojsa qato që e dijsa. Jonë konë shumë okej, shumë korrekt me neve.

⁹ *ito Prometi*, kompani ushqimore në kohën e Serbisë.

¹⁰ Gjerman: *Pinzgauer*, automjet ushtarak.

¹¹ Serbisht: *Kasarna*, barakë, kazermë ushtarake.

Erëmirë Krasniqi: Ju bojshin pyetje rreth rastit t'masakrës?

Bajram Kafu Kinolli: Na bojshin pyetje rreth rastit t'masakrës, jonë konë krejt me televizione, jonë konë krejt me kamera ashtu, jonë konë *big* [e madhe] o njeri. O konë krejt mahalla...

Erëmirë Krasniqi: A kanë qenë trupat aty hala?

Bajram Kafu Kinolli: Hala trupat, i kishin kallë krejt trupat, a din qysh. Se i kanë [marrë] prej shpijës, e i kanë qitë krejt me ni shpi tjetër edhe i kanë kallë krejt trupat. Une s'e dijsa tash kush çka aty ka ndodhë, veç po m'kallxon njoni prej reporterëve, po thotë, "Osht' familja... kjo familja Vesa". Veç mu m'ka shku n'men, se diqysh e kom pasë shoqe, po shoqe t'klasës, jemi konë n'klasë pesë vjet. Edhe, Vesa edhe familja Caka. Vesa o konë profesoresha, Caka o konë çika e klasës tem që veç vëllavi i ka pshtu edhe baba i vetë që osht' n'Amerikë.

Edhe morra vesh o njeri, a din o konë, shumë o konë *sad* [trishtueshëm] o njeri. U konë shumë *sad* se po menoje na n'mahallë jemi rritë bashkë, plus a p'e din qysh, kojshia diqysh... edhe e dijsa që kom kalu qanena.

Erëmirë Krasniqi: Qato ditë?

Bajram Kafu Kinolli: Qato ditë e dijsa që kom kalu qanena, profesoresha diqysh, profesoresha e muzikës.

Erëmirë Krasniqi: A osht' e njejta qajo që kërkoi shërbim prej teje me i çu qumësht, a tjetër?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, kjo e Edukatës Qytetare, e Edukatës Qytetare o konë. E ajo o konë... s'e di une kur jom dalë n'shollë, une e hupa faktikisht m'pat hupë ni vit, se s'kishim pare me e pagu atë përqindjen.

Erëmirë Krasniqi: Tre përqindshin?

Bajram Kafu Kinolli: Po, tre përqindëshin e ku ta di une. Edhe une i pata hupë krejt kontaktet me klasën që kom pasë. Hina me ni klasë tjetër që jonë konë... filloi shkolla. Po, para se me fillu shkolla osht' ni rast shumë tragjik që ndodhi te na, erdhën UÇK-ja atëherë kur kesh te shpia e gjyshes, se dashta me u lidhë qaty, se po m'hupë kanihere.

Osht'... jetojnë n'Gjermani, ata kanë shku n'vitet '89, '90. Edhe plani i tyne o konë me ardhë këtu, me punu atje, me i bo senet, me bo shpi. Secili e ka pasë, kjo shpija jonë o konë me katër vëllazën, kjo tokë i ka katër ari, secili i ka pasë kah ni ari me nda edhe secili ka pasë me maru shpinë e vetë edhe me kry, po menoje me jetu. Secili jonë konë t'martumë edhe kanë çu shumë sene n'vitet e '90-ta, u dije që çojshin shumë sene, ku ta di une. Çojshin deri te pllakat, a p'e di qysh të WC-së,

çojshin shole, çojshin krejt senet e paketume, me letra, dokumenta ku kanë m'i qitë me plane, me zorra, krejt jonë konë ashtu.

E gjyshja këtu e ka pasë krejt qat' dhomën komplet, ia rujke djemëve t'vetë çka i çojshin në të '90-tat, edhe ia rujke. Bile, bile gjyshja kanihere s'na ka japë as sene që na kanë çu neve diqysh, qaq o konë që, "Une s'di!" {ngritë duart lartë}. Ajo o konë shumë asi, "Une s'di!" S'dijke as me lexu. Kjo o konë... halla jem o konë pak e smutë ashtu, domethonë s'osht normale. E tash na s'mujshim me ia pre gjyshës, s'din, s'din. E krejt o konë shumë normale diqysh.

Edhe erdhën UÇK-ja tash n'mahallë te na, ikën UN-i. E kryne UN-i punën e vetë, erdhën UÇK-ja n'mahallë te na, n'kamion, 15 veta, krejt t'ri, krejt asi hangara, mangupa, u sillshin shumë keq. Erdhën, po hijjnë n'shpi, une motrat i kisha n'atë moshën 20 vjeçe a po kupton diqysh, 20, 22, qaty i kisha motrat. Edhe tonë kohën t'u m'i ngucë, hinën mrena t'u i ngucë motrat e mia diqysh, nër sy t'babës, nër sy t'nonës. "Hajde ti me neve, ti ki me ardhë me neve", kështu tonë kohën. A e din, jonë konë asi tentime për...

Erëmirë Krasniqi: Dhunime?

Bajram Kafu Kinolli: Për dhunim. Edhe tash po hijjnë, po thojnë, "Duhet me iu kontrollu na juve se ju jeni konë këtu, mos keni marrë najsen prej ktuhit. Gjinja s'po kanë çka me hongër, duhet me japë naj donacion ju, najsen". Lypshin tonë kohën pare, lypshin dukat, lypshin çka t'gjojshin. Edhe tash, gjyshja anena, ish vetëm, tash na po dalim krejt anena. Diqysh i kemi pasë çelë muret që jonë konë *prollaze*¹² atyne herë, që i patëm bo hazër n'vitet e '90-ta që me kalu, se e kemi pasë krejt *zid* [muri]. Edhe, po dalim anena, ata po hijjnë anej {tregon me duar}, gjysa tjetër. Mama po del anena, baba me zemër i smutë o konë. E pat bo bajpasin në '97-tën, edhe po del anena, po hijmë mrena. Jonë hi e kanë thy derën, asaj dhomës tjetër se gjyshja s'dojke me ia japë, ajo qasi o konë... a din qysh, "Kush jeni ju? Çka po doni n'shpi teme? A p'e di qysh?", shumë normale a p'e di qysh. "Kush jeni ju? Çka keni? A keni dokument?" E kanë thy derën, e kanë pa tonë ato sene, e kanë thirrë kamionin, e kanë ngarku kejt senet. Kejt senet i kanë ngarku plus, plus dojshin me ma dhunu motrën, motrat e mia, edhe plus tonë atë abuzim babës tem, që s'i lejke baba jem, dojke m'u kapë me ta, a p'e din qysh, o konë shumë normale me e mbrojtë territorin tond diqysh. Pushkën n'fyt ia shtijshin. Tonë kohën ishim qaty, kejt na e drejtojshin [armën], s'kishim çka me bo, diqysh veç i merrshin senet, çka t'dojshin merrshin. Vijshin kojshia njeri, kojshia pak ma poshtë anej, vijshin merrshin, "Oh, qikjo e jemja." Kishe.

Deri n'mramje, unë... bajegi ni ditë shumë intenzive ajo. Kur e paramenoi sot çka kanë bo ata njerëz, që shumicën e kohës jonë edhe t'lirë, kanihere i shoh edhe rrugës, jo veç te na, po osht' edhe ajo mahalla, lagja poshtë atje. Osht'... ka mahalla tjera, garant kanë bo edhe n'mahalla tjera përderisa kanë hi qështut. Ajo osht'... po shihet pak që o konë e organizume. Kqyre, ata noshta s'jonë konë

¹²Serbisht: *Prolaz*, vendkalim nëpër oborre në mes fqinjëve. Ndryshe njihet me termin turk. *kapicik* [lexo: kapixhik.]

UÇK o njeri, po veç shumica e njerëzve kanë veshë tesha edhe [kanë bo] plaqkitje. Edhe qysh shkoi ajo, thjeshtë dul ni person, mama jem ka punu n'spital gjatë kohës t'luftës. Domethonë, gjatë kohës t'bombardimeve o konë, për çdo ditë osht' dashtë me shku n'spital. Edhe o kanë njoni prej njerëzve që jonë konë t'plagosun aty, o konë UÇK edhe nona jeme tonë kohën u kujdesë për qat' personin. Se i ka pasë secila dhomë e ka pasë pastrusen, se motrat s'jonë konë aty, shqiptaret nuk kanë punu mo. Serbet s'kanë dashtë me i kqyrë o njeri. Tash merre me men, pastrusja me kry punën e motrës medicinale. Mama e ka kry qat punë, ka la plagë, ka la... ka hekë komë t'preme, ka bo ksi, ka pastru gjak... edhe diqyshm ka pa shumë sene që s'o dashtë me i pa, edhe hala osht' e fortë. Hala o dashtë me shku n'punë, po s'erdhe n'punë kanë ardhë t'kanë vra se e kanë ditë ku je.

Domethonë o konë bajegi shumë vështirë për ta. E tash qai personi që mama jeme ia ka la plagët, që o konë i plagosun n'komë edhe plus u konë dervish. Babën tem e murrën atë natë, n'kamion e hypën n'kamion edhe e çunë, ku ta di une ku e kanë çu. S'e di ku e kanë çu. Na ishim n'shok. Vëllai i madh nuk ish këtu se shkoi n'Shipni ai, se ai e dike baba çka ka me ndodhë, ai e ka ditë kejt çka ka me ndodhë. Ai përpara, si kanë dalë serbët, ka thonë, "Kqyre tash, u kry lufta. Lufta e parë o kry, tash e kemi luftën e dytë." Qështu tonë kohën ma bojke, na bojke diqysh. O konë shumë n'stres, o konë qaq n'stres n'kohë t'luftës sa ai hupi o njeri, ai faktikisht e kapi edhe skleroza pak, n'atë aspektin që...

Erëmirë Krasniqi: Harrojke?

Bajram Kafu Kinolli: Harrojke o njeri. Harrojke, harrojke, nuk mujke me u artikulu me tema kur folshim, s'ish mo personi i njejtë, a p'e din qysh. Thjeshtë mas maltretimeve, mas tonë ato gjanave që s'mujke m'i përtheku kejt. Çka me hongër, çka me pi, a p'e din qysh... stresi thjeshtë. (Kollitet) A ma jep qat' ujë? Eh *thank you* [falemnderit].

Erëmirë Krasniqi: Nana jote a e njofti njenin prej atyne?

Bajram Kafu Kinolli: Po, domethanë, e hypën n'kombi babën, mama tha, mama i tha atyne, "Une nuk e lëshoj burrin tem vetëm," a p'e din qysh. Edhe kur jonë shku në qat' venin që i kanë çu, që i thojshin kasaphane, që o konë kasaphanja e vjetër n'Gjakovë, kur u shku aty e ka pa njerin që e ka shëru mama jeme me dur të e veta, ai si udhëheqës, a ku ta di une edhe qysh na ka kallxu storien, e kanë marrë n'pytje këta, "Ku i keni marrë këto sene?" Ky baba krejt letrat i ka mledhë, i ka marrë me veti, që i ka pasë prej doganave, prej ku ta di une, që i ka marrë krejt komplet listën, që i ka me emër e mbiemër, me numër serik e me kejt që i kanë çu prej atjeshit. Veç një minutë [i përgjigjet dikujt që po e thërret]. Edhe... "Jo, ju i keni vjedhë," tha. Jo ai, tash osht' dikush tjetër aty, s'po di kush osht' ai tjetri. "Ju i keni vjedhë," tha diqysh, "edhe duheni me pranë që i keni vjedhë, mos ta bojmë t'madhe. Burrin duheni me lonë këtu," tash t'u ia bo mamës, tu ia shti... tash frika, a p'e din qysh, duhesh me pranë këto ose shkutë dytë, a p'e di qysh.

Kjo po ia bon, qysh na kallxojke mama, “A po t’kujtohna, a jo?” Tash atij që ish n’tavolinë t’u shkru. Ai shkrujke kishe çka po folin këta, ai majke shënime, a p’e di qysh. Edhe ia bojke, “Dervish, a po t’kujtohna, a jo?” “Jo s’po m’kujtohesh.” Qaq.

Erëmirë Krasniqi: Përnime e ki a?

Bajram Kafu Kinolli: “Jo s’po m’kujtohesh.” Qaq. “Qysh bre dervish?” O shku mama jeme i ka pshty n’fityrë ashtu taman. “Qysh bre s’po t’kujtohet? E ki t’plagosun kamën? E ki qitu qët’ shejë. E ki qitu qët’ shejë. E ki qitu qët’ shejë {tregon me dorë}. T’a kom la bythen, t’kom qitë m’u pshurrë, t’kom qitë aty. T’kom japë bukë, t’kom pru bukë prej shpisë edhe qito po don me ma bo qështu a? “S’po t’njoh a?” “Auu ti koke, Sofije.” Qe!

Kejt qajo, me ni dokument shkrunë kishe familja jonë ka jep donacion për njerëzt që kanë pasë nevojë për gjana që jonë konë këtu, që osht’ shuma për afërsisht një qind mijë euro.

Erëmirë Krasniqi: Kokët shumë t’pasun ju!

Bajram Kafu Kinolli: Po, shumë jemi t’pasun. Edhe me qato për shembull n’Kryq t’Kuq, mujshe me marrë ndihma masnena, se përndryshe s’mujshe me marrë ndihma, romët s’kanë mujtë me marrë ndihma.

Erëmirë Krasniqi: Përnime? Pse kush i kontrollojke ndihmat?

Bajram Kafu Kinolli: UÇK-ja.

Erëmirë Krasniqi: S’jonë konë ndërkombëtarët?

Bajram Kafu Kinolli: Jo. Pa pasë letër prej UÇK-së që ti je i pasur, i pastër që s’ki bo kurgjo kishe, që ki japë naj donacion a ku ta di une, ti s’ke guxu bile me hi n’ren me marrë ndihma.

Erëmirë Krasniqi: S’ka pasë kurgjo qashtu diçka të institucionalizime që ata me pasë t’drejtë me [marrë prej juve]...

Bajram Kafu Kinolli: Kjo osht’ gjakovarski po m’doket mu {ngritë supet}.

Erëmirë Krasniqi: Qysh prindët e jujë vendosën me nejtë këtu mas krejt kësaj?

Bajram Kafu Kinolli: Kqyre na dojshim me ikë, ish ai tensioni me ikë o njeri, ish ai tensioni me ikë. Kjo a p’e din qysh, tonë kohën ish ai tensioni me ikë. Na i thojshim, une i thojsha babës tem, “Hajde t’ikim,” a p’e din qysh, krejt fëmija i thojshim, “Hajde me ikë.” Po ai thojke, “Jo, s’keni nevojë me ikë se s’jeni të zhlyënë. Se po ike ti, i jape shansë atij, motiv i jape që je konë i zhlyënë. Në qoftë se des, des

n'shpi teme.” Qështu ma bojke tonë kohën. S’dojke me ikë njeri, a p’e din qysh, s’na lejke as neve me ikë.

Erëmirë Krasniqi: Jo me ikë, po mendova veç...

Bajram Kafu Kinolli: S’kishe ku m’u largu o njeri, krejt kufijtë ishin mbyllë faktikisht n’atë kohë, se osht’ vonë ajo. Ajo koha kur u setapitë¹³ ... KFOR-i hala s’jonë dalë n’terren, hala s’pe din mapen, ku janë çka janë, kush osht’ romë, ku janë ata. Kallshin shqiptarët shpija t’serbëve, ashtu fëmija kallshin shpija t’serbëve ashtu, sa për qef a p’e din qysh. Nejse, a p’e din qysh, une e kuptoj shumë mirë atë mllefin. E kuptoj shumë mirë që preken, e kuptoj shumë mirë... po çka kom une faj diqysh. Ti a nuk u msove boll deri n’atë aspektin që ty ta bonë tonë kohën qështu, tash ti po ia bon dikujt tjetër, a p’e di qysh. A s’po të doket qikjo, që ti je t’u ra në nivel me t’njejtin që t’kanë pre, t’kanë vra... a din qikjo o konë seni që tonë kohën baba jem thojke, “Kurrë hallall s’kom me ju bo. Kanë me vra njoni-tjetrin, kanë me hongër njoni-tjetrin këta”.

A din, o konë shumë n’mlefe edhe... mas kejt asajna, u qetësu situata. U qetësu situata edhe u pajtumë o njeri me qat sen. Diqysh, s’kishe çka me bo tjetër, diqysh o konë shumë normale me u pajtu [me] qat’ sen. Ku me shku? Çka me bo? Pare s’kishe. Kontakt s’kishe jashtë. Vende s’kishe, telefon s’kishe kujna me iu drejtu ashtu. Vëllavi ish n’Shipni.

Erëmirë Krasniqi: E këta n’Gjermani që i keni?

Bajram Kafu Kinolli: S’mujsh... s’kishim telefon o njeri, s’ka pasë telefon. Ti me shku me folë n’telefon o konë në Çarshi t’Vjetër, që o konë nifare, s’e di cila organizatë faktikisht e majke nifare telefoni satelit, asi i madh që jonë konë përpara. Edhe u duhshe me pagu, për ni minutë o konë, s’e di o konë njizet marka m’doket ni minutë me pagu. Edhe e di shumë mirë që qai sen o konë vullnetar me bo, nuk u konë për me pagu, po gjinja kanë përfitu prej asajna. Pritke reni njeri prej gjashtë e mëngjesit, pritshin veç me folë gjinja.

Pra ’99-shi kur kaloi, 2000-shi ra pak ajo... qetësimi. Ia nisën me ndërtu, ia nisën shkollat me funksionu, edhe tash mama edhe baba po ma bojnë, “Osht’ shumë rrezik me shku n’shkollë. Na po kemi qef, po osht’ shumë rrezik me shku n’shkollë”. P’i thomë, “Hajt bre babë veç ta provoj se une i kam shokë këta, ata m’mbrojnë,” a p’e di qysh. Baba, “Shumë rrezik me shku n’shkollë.” Ma bojke. S’kish qysh me ma spjegu tjetër qysh.

Erëmirë Krasniqi: A shkove?

Bajram Kafu Kinolli: Une shkova n’shkollë. Shkova ditën e parë se i kisha këta t’lagjes këtu, do prej tyne, do prej romëve, jonë konë pak ma t’bardhë edhe kanë dalë n’Shipni ata. Tash une i kisha qata djemë, isha n’gjeneratë me ta faktikisht, që e hupa vitin isha n’gjeneratë, të njejtën gjeneratë me ta.

¹³ Anglisht: *set-up*, në zhargonin shqip përdoret si: instalu, vendos.

Edhe ata ishin... ata nuk e kishin përjetu luftën hiç, ata jonë dalë ma heret. Do me t'parën, se romët nuk i lejshin... po faktikisht, për shkak që ishin ma t'bardhë edhe u dokshin si shqiptarë edhe i kanë lonë. Ata jonë kanë n'Shipni tonë kohën. Tash une i kisha shokët e mi qitu t'mahallës, une i thojsha babës tem, "Okej, unë jom me shokët e mi, nuk ndahna prej atyne." A p'e di qysh. "Krejt ka me konë n'rregull, mos u tut ti. S'kanë çka me m'bo, çka kanë me m'bo mu, 15 vjet? Pse kanë me m'ngucë mu?" A p'e din qysh. "S'kanë çka me m'ngucë mu".

Fillimi ashtu shumë i vështirë, na shtijke drejtori me bo asi homazhe që s'merrsha vesh pse me bo asi homazhe kur na erdhën do emna të UÇK-së për me bo homazhe. Adem Jashari, kush osht' Adem Jashari? Nuk e dijsa kush osht' Adem Jashari. Nuk e dijsa çka po ka ndodhë, diqysh ishin... u ndërru struktura, profesorët ishin ashtu me nivel shumë, s'e di o njeri, shumë [të] vrazhdë ndaj neve. Se na ishim, në qat' klasë që dulëm, ishim faktikisht 12 veta, 12 romë që ishim faktikisht në krejt shkollën. Na shtijnë qaty me ni klasë po edhe me shqiptarë. Diqysh u konë trip i mirë me klasë, u konë shumë mirë, jemi konë klasë e fortë. Jemi konë nashta klasa ma e fortë n'shköllë, i rrehshim tonë o njeri, mo.

Erëmirë Krasniqi: E fortë kështu fizikisht (qeshë)?

Bajram Kafu Kinolli: Yeah [Po], se u bomë shumë t'fortë a p'e di qysh. Se s'kishe ndryshe mo, u duhke me iu japë tutë dikujna. Edhe kejt seni n'rregull n'shköllë, po kish asi probleme, "O magjup!" Masnej ia nisën shumë, "Ju jeni me shkije, ju s'e keni venin këtu", blla blla blla. "Ju tona herë jeni konë me shkije." Prapë, po ashtu tonë kohën ka pasë qësi sene, a p'e di qysh.

Erëmirë Krasniqi: E këta romët që i kishe n'klasë, a i kishe prej mahallave tjera?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, prej ktuhshit, krejt t'mahallës, krejt t'ni mahalle i kemi pasë, se osht'... u konë shumë interesant, a romët tjerë s'kanë shku n'shköllë mo. Domethonë 2000-shi o konë shumë rrezik, po na që i kemi pasë shumë afër shkollat. Shkolla osht' faktikisht as dhetë minuta me ecë n'komë, o konë shumë shpejtë, edhe jonë konë shumë rrugica t'vogla që shkojshim na. Edhe n'shköllë, po menoj, drejtori pijandurë ashtu. Tona herë u konë pijandurë ai. I rrehke fëmitë i sakatojke, a p'e di qysh, shpesh herë edhe mu m'ka rrehë, a p'e di qysh. Durtë qekat m'i pat bo {i tregon shuplakat}.

Erëmirë Krasniqi: Qysh? Veç dilke nëpër shkollë edhe.... (qeshë).

Bajram Kafu Kinolli: Jo, jo, për shembull, ti je... jo, jo, po osht' për shembull, ti je vanu pak, "Pse je ardhë ma herët¹⁴ n'shköllë?" Je vanu pak n'shköllë, diqysh ni minutë je vanu. T'ka nxonë n'korridor, t'ka shti n'zyre, t'ka rrehë o njeri. Ose ti me dalë me lujtë, faktikisht arsitmarja me mungu edhe ti me dalë n'korridor veç me nejtë qështu te dera, ai t'ka thirrë n'zyre edhe t'ka rrehë.

¹⁴ I intervistuari ndoshta dëshiron të thotë më vonë.

Erëmirë Krasniqi: A s’o dashtë ai me u marrë me menaxhment t’shkollës?

Bajram Kafu Kinolli: Po krejt n’rregull... ai o konë shumë maniak, ai osht’ psikopat, a p’e di qysh, o konë shumë psikopat o njeri, shumë psikopat. Mu çekiç m’ka ra njeri n’shpinë, ni javë ditë s’kom mujtë me ecë, pse jom hi ma heret n’shkollë. Jom hi ma heret n’shkollë, kemi dashtë m’u ndërru.

Erëmirë Krasniqi: A e ki paraqitë n’polici?

Bajram Kafu Kinolli: O konë shumë moti o njeri, jom konë n’klasë t’shtatë, a p’e di qysh... mas 2001 qatëhere faktikisht. Edhe...

Erëmirë Krasniqi: Po m’intereson qiky aspekt, qysh i keni....

Bajram Kafu Kinolli: Qiky aspekti... qiky drejtori osht’ dalë prej shkollës, se i kemi qitë, faktikisht do njerëz e kanë qitë prej organizatës. Ma vonë unë e kom lajmru këtë drejtor edhe e kanë qitë prej atyhshit.

Erëmirë Krasniqi: Qajo po m’intereson, raportin me ligj qysh e keni pasë ju si komunitet.

Bajram Kafu Kinolli: S’ka pasë ligj o njeri, ku, kujna? Jonë konë do policia “Koka kolla” që i thojshin (qeshë), “Xhipa koka kolla,” që i thojshin. Kujna e ku me iu drejtu, a p’e di qysh. S’o konë as regjistrimi, s’o konë as... s’ka pasë aty diqysh, o konë shumë vështirë.

Për shembull, baba jem, me kejt mahallën këtu, delshin e rujshin o njeri, natën. Bojshin ndërrime, a p’e di qysh.

Erëmirë Krasniqi: Ju jeni vetë-organizuar?

Bajram Kafu Kinolli: Vetë-organizimi o konë n’maksimum, tonë kohën o konë. Përafërsisht nja katër-pesë mujë, tonë kohën o konë. Për çdo natë dilshin e u ndërrojshin. Masnej ma mytën djalin e axhës, t’babës, n’mahallë qëtu qi e kom pasë, 21 vjet u dalë me kolicë me punu, e mytën o njeri.

Erëmirë Krasniqi: E sulmunë n’rrugë?

Bajram Kafu Kinolli: E kanë rrehë. N’pazar o dalë me punu, e kanë nxonë me naj qosh dikah, e kanë rrehë, dhetë ditë s’kemi mujtë me gjetë. Tash osht’ shumë interesant ai pozicioni, “Hyp se t’vrava, zhdryp se t’vrava”, tash a m’u konë me këta, a me konë me ata. A din qysh, atë pozicionin shumë ma vonë, deri kur baba jem fitoi bash trauma, krejt senet i fitoi n’fund edhe vdiq 41 vjet. Isha bash n’klasë të tetë, që e kryva klasën e tetë, dy ditë para maturës vdiq baba.

Isha rrëzu prej bicikllës (qeshë), qikaq e kisha synin {tregon me duar madhësinë} shumë interesant o konë tripi. Punojsha me ni magazinë edhe shkojsha n’shkollë në qat’ kohë. Shkarkojshim sheqer e mill e ku ta di une, ishim... ky baba jem e ngjihke qat’ pronarin e magazinës, o konë pejon po i

ardhun n'Gjakovë. Punojshim se u duhke me majtë najqysh... s'na jepshin punë tjetër, a p'e di qysh. Edhe u rrëzova me bicikël unë t'u ardhë prej punës. Mas dy ditëve baba qitu ish {tregonin vendin ku ka qenë ulur}, si... e premte o konë, nesër n'mëngjes u smu qaty n'oborr. Ishim t'u hongër mengjes, u smu, shkoi n'spital, vdiq. Diqysh shkoi shumë shpejtë, kaloi, po meno j krejt e hane, krejt qajo ditë. T'u pritë une, erdha prej shkollë, e kryva shkollën faktikisht, se matura ish masnej si... qat' javë e kishim, t'mërkurën a diçka, masdite e kishim. T'hanën vdiq baba, kaloi shpejtë, unë s'mujsha me shku as gjysëm-maturë, matura. Shkoi jeta, diqysh shkoi nifar periudhe që *blackout* [errësim i plotë].

Vëllavi erdh këtu, hini n'punë edhe diqysh krejt n'rregull, ia nisi me punu shumë mirë, po ajo periudha '96 deri në 2001 maj, 21, une s'e maj n'men babën tem hiç mo. Deri qaty ai ka nisë *flipi*¹⁵ i tijna, s'ish mo ai diqysh... shumë n'stres, ish tonë kohën nervoz, ish tonë kohën t'u kqyrë lajme ashtu, si, si i çmendun, tonë kohën. S'mujke, as nuk dilke, nuk ish ai njeri, ai burrë që e njihsha ma heret. Nuk ish ai njeri me m'kapë për dore, "Hajde po shkojna dikah, hajde po shkojna me ecë." E kejt ndodhi për shkak të konfliktit që na s'ishim as n'këtë anën, as n'atë anën tjetër.

Erëmirë Krasniqi: Qitu po du...

Bajram Kafu Kinolli: E faktikisht na ishim me njonën anë, me thonë t'drejtën, ishim. Se na folshim shqip o njeri, na folshim. Une shkojsha n'shqip, mama jeme shqip ka shku, gjyshja jeme shqip ka folë, stërgjyshi jem shqip ka folë, a p'e di qysh.

Erëmirë Krasniqi: O konë pjesë e kulturës.

Bajram Kafu Kinolli: Edhe tash, erdh koha mas luftës, kejt ato sene që na ndodhën, kejt ato sene që s'o dashtë me ndodhë, ndodhën. Vdiq baba edhe filloi krejt ni jetë ndryshe. Hina n'shollë t'mesme.

Erëmirë Krasniqi: Athu kjo situtatë që përnime keni qenë... momentin që ti e flet ni gjuhë, normalisht që aty zhvillohet mendimi, je pjesë e qasaj kulture. Po qiky momenti mas luftës, a iu ka qitë n'asi pozite që s'jeni as knej as anej, po, ajo medoemos ju ka pru në ni pozitë ku ju jeni dashtë me zhvillu pozicionin e jujë. Po m'intereson çka ka ndodhë me jetën e jujë kur ju mo, jeni diskriminu për shkak që keni qenë pjesë e kulturës shqiptare, mandej mas luftës iu osht' mohu me qenë pjesë e kulturës shqiptare. Po, a ka qenë moment që ju e kuptoni qysh n'fakt s'keni nevojë me qenë me kërkon, ishit dashtë me zhvillu nifar fuqie si komunitet për me mujtë me....

Bajram Kafu Kinolli: Po faktikisht fillunë ato partitë politike në atë moment. Domethanë, ka pasë parti politike egjiptiane, ka pasë parti politike rome, ka pasë parti politike ashkalike. Po meno j, une nuk e kom ditë o njeri çka osht' rom me konë, a p'e di qysh. Une kurrë s'e kom ni fjalën rom, a p'e di

¹⁵ Anglisht: *flip*, rrokullisje, inatosje. Në kontekstin e dhënë ka kuptimin e ndryshimit, marrjen e teposhtzës.

qysh, n'shpi teme asnihere o njeri. Osht' "magjup", "gabel", "çërgash", këta jonë konë senet që i kemi ni n'rugë, ose i kemi pasë shajtje tonë kohën me qësi far lloje. Unë vetë e kom bo qato pa dijeni, diqysh nuk e dijsa çka osht' ai sen. Gabelët jonë konë ata që kanë folë romë, romisht; magjupët jonë konë këta që kanë folë shqip, çërgashët jonë konë ata që kanë lypë. Qito jonë klasifikimet që jonë nda prej romëve, ose prej neve kështu, prej komunitetit mrena.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë nuk jonë nënçmuese ato?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, jo, për neve nuk jonë konë veç klasifikime ashtu, *but* [por] diqysh o konë... romë shumë ma vonë, në 2002-shin që e kom ni fjalën romë. Masnej m'ka interesu, ma vonë m'ka interesu. Vëllavi ma thojke, "Na jemi egjiptianë", i madhi. Ky n'shkollë ma bojke, "Ju jeni romë". Dilsha n'rugë dikush tjetër ma bojke, "Ju jeni ashkali". Veç ia fillojke ... 16 vjeç, ky truni shkojke ashtu gjithkah njeri. Ku jom? S'kishim literaturë, s'kish internet... po menoj kish internet, po u konë shumë fillimi, s'kishim informata o njeri diqysh. S'kishe informatë qaq sa duhet. Shumë o konë *weird* [çuditshëm], hala njeri e ki atë nivelin... Po e murrën këta, si partitë politike, e murrën pozicionin e vetë, Haxhi Mërgja që i murrë romët.

Ke ky i Gjakovës, qysh e pat emrin, i egjiptianëve, po ia harroj emrin. Nejse ai ashkaliu i Ferizajit që e boni atë skandalin ku ta di une, që bojke pashaporta, letra e ku ta di une, që osht' në Gjermani. Edhe a di qysh, ata bonë parti, po, po hinën n'parlament, që e bonë parlamentin e Kosovës. Diqysh u bonë votimet, masnej hinën n'parlament. P'e kqyri... po menoj, kush osht' Haxhi Mërgja me m'përfaqësu mu, a p'e di qysh, kush osht' ky tjetri i Gjakovës me m'përfaqësu mu, përderisa, ti si lider nuk je ardhë me m'kallxu mu kush jam unë që e kom pasë pytjen për tri vjet t'u e bo. Kush jam unë? Pse po m'thirrin mu magjup, ose gabel, ose çërgash, ose romë? Pse po m'thojnë mu qito sene... ose ashkali ose egjiptian?

A e di, jonë konë shumë sene interesante... *confused* [i hutuar] jom konë shumë. Edhe masnena une nuk hijsha n'atë aspektin që me marrë vesh kush jom une. E lashë mo ato, e diqysh, e dijsa që si t'ia nisim politikë këto sene me u marrë, po menoj e dijsa prej... që m'kallxojshin njerëzit ashtu pak ma t'vjetër që rrijsha me ta. Vëllavi m'kallxojke, "Mos u merr me qësi sene" diqysh, se punojke me organizata që e dijsa çka o ka ndodhë. Krejt osht' punë biznes, krejt osht' punë vota, veni, karriga, kurgjo hiç. "Mos u merr me këtë punë hiç. Çka po pytë ksi sene? Vazhdo ti tonden".

Shkova n'shkollë t'mesme, super, në shkollë ekonomike hina, ekonomi t'përgjithshëm. Super kom kalu aty edhe pse kom pasë psikopata profesorë, ashtu që t'dalin prej luftës UÇK, ku ta di une. Adem Jashari, unë s'kam gjo kundër Adem Jasharit, a p'e di qysh, Adem Jashari, Skënderbeu, Tito, krejt diqysh. Po osht' shkollë ajo, osht' *heroes, who is this heroes? It's not my heroes* [Heronjtë, kush është ky hero? Nuk është heroi im], a din. S'o konë e ngjitme qajo me mu. Une i kom mësu [në] histori, a p'e di qysh, po *what's the point? Where is the other side?* [Ku është poenta? Ku është edhe ana tjetër?] Pse s'po ma qesin mu qat' histori? Ku janë romët n'pjesën e historisë kosovare? Çka

kanë bo romët, pse, sa romë jonë t'mytun, sa romë jonë t'zhdukun? Sa mahalla o djegën e romëve? Asnjo nuk fliten këto sene, a p'e din qysh.

Erëmirë Krasniqi: A ekziston naj organizatë, a dikush që mirret me naj lloj investigimi...

Bajram Kafu Kinolli: Ekziston organizata, po ekziston organizata veç me shpërla pare që vijnë vetë prej romëve, që osht' gabimi ma i madh që ekziston n'Kosovë, besimi që s'kanë kapacitet me e kry atë punë. Shumë thjeshtë, kush e myti djalin e axhës tem? Pse s'po gjindet, a din qysh? Dhetë vjet, 15 vjet u bonë gati. Shumë thjeshtë, vazhdon koha e luftës edhe vazhdon jeta shumë normale.

Shumë i ri, fillojë jeta normale n'shkollë t'mesme me shoqni krejt tjetër, shoqni shumë t'mirë kom pasë, jonë konë shumë t'respektueshëm, edhe pse ditën e parë jom rreh me njonin. M'ka thonë, "Magjupë, ju s'keni vend këtu!" E kom kapë e kom mytë t'u e rrehë. Edhe o ardhë drejtori ditën e parë m'ka thonë, "A e çlirove ktuhën, çka bone tash? Pse e rrehve djalin?" "Po m'thotë magjup." Qaq edhe e ka mshelë gojën. Edhe me qat' djalë, mas ni jave shokun ma t'ngushtë e kom bo. Po diqysh shumë o konë trip interesant, ditën e parë, del n'shkollë t'mesme edhe rrehesh edhe bon shok t'mirë. Krejt... (qeshje). Osht' shumë *weird* o njeri, do sene që qitash kur po m'bijnë n'mend, ashtu... oooh, shumë paradoks, shumë *stupid* [marrëzi], shumë të painformumë tonë kohën diqysh... S'e di mu noshta rruga m'ka rritë në qat' mënyrë, që jom dalë kom shitë cigare, kom nejtë me njerëz pak ma t'vjetër, kemi bo biznes, folshim për sene t'ndryshme, për politikë, për majtistë. Folshim për... o konë shumë interesant, shumë interesant o konë.

Unë jom dalë vetë në '98-shin, jom konë n'listën e studentëve... po meno jom dalë n'protesta me krejt shkollën, me profesorë. Fëmitë krejt tjerë i kanë marrë, i kanë, i kanë çu fëmitë n'shpi, une jom konë me profesorë.

Erëmirë Krasniqi: N'Gjakovë a?

Bajram Kafu Kinolli: N'Gjakovë kur u konë marshi. Dy-tri herë jemi dalë, policia rrijshin qaty, kurgjo s'ka ndodhë, po jom dalë n'marsh.

Erëmirë Krasniqi: A munesh me na folë për aktivizmin tond?

Bajram Kafu Kinolli: Okej. Aktivizmi im fillon me marihuana (qeshje).

Erëmirë Krasniqi: *That's not...* [Ajo nuk...]

Bajram Kafu Kinolli: *Right...* [jo e duhur...] (qeshje). Jo s'e di, aktivizmi ka fillu kur ia kom nisë nashta me u marrë pak me organizata, me qendër rinore n'fillim n'Gjakovë. Rinia, pak a shumë n'shoqni të ndryshme, fillojsha me e eksploru Gjakovën mas luftës. Kush osht' Gjakova mas luftës?

Para luftës e ngjihsha, shkojsha lujsha futboll e sene... po mas luftës krejt ndryshe, erdhën njerëzt tjerë diqysh krejt... u rrita pak ma shumë. Delsha shumë normal, nuk u tutsha mo.

E qendra rinore ia ka nisë qaty, kom kontakti Latin, o konë ni shok i jemi shumë i ngushtë. Osht' katolik i Gjakovës, ai o konë shumë... hala osht' *cool*, e kom shok hala, ashtu që m'ka japë bajegi shumë suport. M'kanë thirrë tonë kohën nëpër neja ku zakonisht o konë shumë *weird* me shku ni romë nëpër neja shqiptare diqysh. Une jom konë tona here ai që o konë, okej, n'secilën nejë unë jom konë qaty diqysh. Jom konë sikur, për shembull osht' ni djalë n'Prishtinë që i bjen tarabukit n'shesh, po ai i bjen tarabukit a din qysh edhe e bon qat' punë për me marrë. Une jom konë ai tona herë, ai djali që kom pasë qef m'i njoftë njerzit, m'u konë shok me dikon. Kom pasë tona herë nevojë me pasë shok.

Edhe kur u bomë ni grup shumë interesant, o konë organizata "Global Motion". Edhe fillove me teatër diçka, o konë *social dance theater*, edhe qaty ia kemi nisë qashtu. O konë nifar aktivizmi me ni kult t'përzimë mrena, po kurrë s'o merrshe vesh aty çka o ka bohet. Krejt ma vonë e kemi marrë vesh që osht' pak Bahá'í¹⁶, a p'e din qysh, po shumë n'rregull. Qaty kom mësu shumë sene t'mira për shembull. Kom mësu çka osht' iniciativa, qysh merret iniciativa, qysh duhesh me konë komunikativ, qysh duhesh me konë i drejtë, pse duhesh me konë *humble* [modest], pse duhesh me konë i singertë, pse duhesh... a din m'i ka qitë senet taman ashtu tuk, tuk, tuk {tregon me duar}. Kemi pasë asi qarqe t'studimit për çdo dy javë. Une qaty, po meno, shkollë, shkojsha n'shokollë t'mesme, po nuk msojshim kurgjo o njeri. O konë *stupid* shkolla e mesme, o konë *stupid*. Shkolla e mesme o konë *stupid*. Une profesores t'matematikës ia zgjidhësja detyrat që ajo s'dijke me i zgjidhë. A p'e di qysh, o konë shumë *stupid* shkolla e mesme, o konë shumë kaos {lëvizë duart}. Nashta mu m'u ka dokë kaos që jom konë i ri, apo qaq s'kisha nevojë për qat shkollë hiç, s'kisha nevojë me konë qaty hiç, hiç s'kisha nevojë me konë.

Erëmirë Krasniqi: A performojshit me këtë grupin?

Bajram Kafu Kinolli: Po performojshim shumë o njeri. O konë kjo, i ka pasë... o konë shumë interesant si organizatë, o konë shumë e mirë, që e pat financu UNICEF-i qat program për nja pesë vjet m'doket. Prej 2002 deri në 2007 o konë programi. Edhe une pata hi qatëhere. Une ma heret pata ni për atë grupin, edhe dojsha me hi deri sa nxona, une Latin, i nxona edhe do tjerë, e bona venin ashtu... m'murrën njo dy vjet, une 2005, 2004 hina qatëhere me ta, edhe vazhdoi super.

Hina n'teatër, msojshim *step dance, make protest without words, just with movements and beats of your body, clap your body* [Bë protestë pa fjalë, vetëm me lëvizje dhe pulsime të trupit tand, shfrytëzo trupin tand]. E na mësojshin super, une e kapa shumë shpejtë, e bojshim koreografinë. E bomë njifar *show* [shfaqje] t'vogël edhe tash kisha me prezantu n'Prishtinë. Une n'Prishtinë për herë t'parë jom konë në... po n'fund të 2004-tës edhe n'Teatër Kombëtar për herë t'parë *what the*

¹⁶ Arabisht: *Bahá'í*, është religjion monoteist i cili vë theks në bashkimin shpirtëror e të gjithë njerëzimit.

fuck, man. U konë shumë... n'Prishtinë po shkoj në 2004, a p'e di qysh. Edhe u konë shumë lezet, as prindët, s'pi kallxoj as n'shpi, s'guxojsha me i kallxu atyne se s'ëm lejshin o njeri. Ku ki me shku në 2000 e asi...

Edhe tonë kohën jom konë ashtu, tash rebel u bona. U bona rebel pak me t'familjes se nuk e gjejsha mbështetjen prej tyne edhe e gjeta mbështetjen te njerëzt, te qiky kulti që m'kultivojshin shumë mirë që ma jepshin atë forcën, atë dijen, ato qysh me e udhëheqë veten. M'bojshin shumë lider, m'bojshin shumë individualist, m'bojshin tonë kohën... bon prej vetes, a din qysh, m'çelën, m'çelën ashtu si lule. U çela, pranvera u çelë, a p'e di qysh, i harrova kejt o njeri ça ndodhi. Qaq shpejtë i harrova ça ndodhi kjo.

Edhe shkumë n'Prishtinë, e japëm shfaqjen. Aty ishin, e kishin secili qytet, e kish grupin e vetë, edhe une s'e dijsa çka ka me ndodhë. Ishin secili qytet, ishin 150 fëmijë prej Kosovës edhe Maqedonisë. Edhe, ishin edhe serbët aty t'Graçanicës edhe para se me ndodhë ai incidenti...

Erëmirë Krasniqi: Po, po i 2004-tës, trazirat n'mars.

Bajram Kafu Kinolli: Ku ta di une... e qaty o konë interesant qysh u takumë 150 veta. U konë shumë mirë, edhe qatëhere ia patëm nisë me mesengjera me marrë email-a, kemi pasë grupe të mëdhaja. Bisedojshim o njeri qysh me bo iniciativë me mbledhë tesha për njerëz ma t'varfën, me kqyrë me marrë lokacionet me i shkru emnat, ku osht' lokacioni, qysh me i çu krejt e organizojshim. Për shembull, njoni prej aksioneve që i kom bo t'para n'jetë teme o konë, e kemi bo n'Gjakovë, osht' Lagja e Kolonisë, osht' ni lagje shumë e varfën, jeton afër kjo qysh i thojnë... osht' vend i mbeturinave ku krejt Gjakova i derdhë, osht' si deponi e bërlllogut. E jetojnë qaty, jetojnë krejt prej reciklimit... e shumë osht' interesant. Për shembull, njo prej seneve o konë... eh tash kqyre far tripi e kanë pasë këta si kulti që t'thashë ma heret, si Baha'it. Muji Ramazan për ta o konë me t'shërby, ti ki pasë me e bo nji projekt, këta t'shtijshin me bo projekte ashtu, shërbime. Tash ideja jeme o kanë kështu, po i marrim fletushkat e vogla, domethonë dy ditë përpara, i çon fletushkat nëpër banesa. Ishim bllok i ri në Gjakovë. Shkojshim nëpër banesa.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë informata jonë konë?

Bajram Kafu Kinolli: Informatën e kishim, "Kemi me ardhë mas dy ditëve... Jemi qekjo organizatë, kemi me ardhë mas dy ditëve. Nese e ki naj teshë që nuk e përdorë edhe kish mujtë dikush tjetër me e përdorë që është ma i varfën se ti, kishe bo mirë neser me na e lanë nji kесе të lidhne para derës. Faleminderit". Kaq. E lejshim, veç cokatshim ashtu pa na pa, si guerilla jemi kanë, tak-tak. Lejshim derën edhe e patëm mbledh nji kamion t'madh, o njeri.

Erëmirë Krasniqi: Po!

Bajram Kafu Kinolli: I kemi selektu për dy javë ditë se o konë shumë punë e madhe. Jemi konë veç pesë veta, a po e din qysh! Qai projekti për mu osht' konë ashtu, *"Wow, this i can do! This is what makes me happy now! This... I find my way"* [Uau, këtë muj me e ba! Kjo është diçka që më bën të lumtur. Kjo... e kam gjetë rrugën time].

Krejt ma vonë, 2006-2007, jom kapë aty... nejse jom konë ma reper atëhere ashtu... e kishim na asi si "West Clan Records", jom konë me një klan të reperave. E aty jom konë shumë vullgar, ashtu ai reperizimi që o kanë ma uuh {vnon dorën në fytyrë}. Kur i ngoj kanjiherë do sene...o zot, s'muj! O konë shumë ekstreme. Se masanej mas këtij kulti që e mësova barazia gjinore, e ku ta di une, krejt e ndryshoi, diqysh m'boni shumë ma t'butë...

Erëmirë Krasniqi: T'ndryshoi?

Bajram Kafu Kinolli: Po de... ma t'butë. U bona pak ashtu une, n'atë fenë e Bahaive i hina pak me tripa se ata t'merrshin.

Erëmirë Krasniqi: Ee çka ish kjo Baha'i?

Bajram Kafu Kinolli: Baha'i osht' një fe shumë e re, që osht' prej Iranit faktikisht. Baha'i osht' një prej udhëheqësve të tyre, osht' Abdul Bahai, djali i tijna, osht' Shogi Efendi masanena. Shumicën e thanjeve, për shembull e ka Jimi, Jim Morrison, i cili thotë, "Përdersia ti nuk bon paqe me kafshët, paqe s'ka me egzistu te neve". Këta e ka thonë Abdul Bahai, 1800 e diçka. Domethonë, kanë shumë libra, e kanë Haifen¹⁷ për shembull si qendër. Osht' sekt shumë modern muj me thonë në atë aspektin intelektual, janë shumë ma të hapun, por t'njejtat senet i kanë, jo seks para martesës, no gay, a po e din qysh... duhesh me u taku një vjet, m'u pa a muni m'u kanë partnerë. A p'e din qysh, i kanë pasë do rregulla shumë interesante. Lutjet i ki bo çka t'dush, prej Kuranit, prej asaj, s'kanë pasë ashtu caktime.

Erëmirë Krasniqi: Nji libër.

Bajram Kafu Kinolli: Jo, nuk kanë pasë! Veç që i kanë pasë do rregulla ashtu si formë për me e mbajtë. E mu më pëlqejke ashtu, hijsha bajegi shumë n'trip. Po... s'pe di ma vonë... ë-ë {mohon me kokë}.

Erëmirë Krasniqi: E çka bonët me atë kamionin me sene?

Bajram Kafu Kinolli: Po i shpërndamë, i shpërndamë qaty. U konë shumë...

Erëmirë Krasniqi: N'qat mahallë...

¹⁷ Haifa, Israel, vendi ku prehet trupi i Báb, paraardhës i Bahá'i, përcjellësit e tij njihen si Bábís.

Bajram Kafu Kinllo: N'qat mahallë, jonë shumë interesant ashtu. E kemi lonë se o konë një qendër aty që e udhëheqke romët e shqiptarët bashkë, e kishin si *learning center* [qendër e studimit], hala egziston faktikisht. Na ju kemi selektu krejt, ata e kanë pasë listën e njerëzve kush janë, sa anëtarë t'fëmijëve, sa vjet i kanë krejt. Krejt ju kanë japë me paketa edhe i kanë shpërnda.

Erëmirë Krasniqi: E qysh ndodhi me muzikë, a munesh me na tregu?

Bajram Kafu Kinolli: Eh, qata dashta me t'thanë. Në 2006-tën, në vit t'katërt isha... po, atëhere në vit t'katërt, një djallë që nuk osht' larg prej ktuhit osht'... prapë Gjakova osht' shumë e vogël o njeri, prapë diqysh krejt njëfemi. E ai djali osht' djali i njani prej themeluesve të lëvizjes, kjo... të LDK-së. Osht' edhe profesor, ka kry diçka phd m'doket n'Amerikë kohën e fundit. Osht'... Rrahmani e ka mbiemrin. Edhe avokat po m'doket osht' kështu si profesion t'krymë, osht' shumë i mirë. Edhe ai o konë bubnjar. Edhe tash ai e kish ni nejtë ditën, se nejat u bojshin zakonisht në shkollë të mesme ditën se qashtu ish ma lezet, se femnat nuk mujshin me nejtë natën ma shumë. E qai tripi o konë ashtu m'u kanë krejt bashkë. Edhe këta e shifsha si shok, lujshim najherë *counter-strike* edhe ku ta di une.

Edhe ky bubnjeve i bijke. Edhe shumë o kanë shumë interesant se i ngojke Bijelo Dugmen (qeshje). E ka dashtë bubnjarin e Bijelo Dugmes bre njeri. I ka pasë krejt CD-at e Bijelo Dugmes, se baba i vet ka studiu n'Beograd, e tash ia ka lanë krejt muzikën ktijna e ky totalisht shumë i gjonë me muzikë, ma i gjanë se sa une. Une isha muzikën e vjetër, isha ilahi, isha aty-këtu Guns N' Roses, a ku ta di une naj Artic Monkeys... shumë pak diqysh. Kur u takova me ta, ai e kish datëlindjen. E e kish marrë një bend aty, po menoj një bas gitare edhe bojshin muzikë ata. Une tash, ata ia nisën me knu Guns N' Roses, e kishin "Sweet Child of Mine". Edhe une e dijsa kangën edhe veç kom kcy n'mikrofon edhe kemi knu kangën edhe ata u fascinunë ata, "Sa mirë po knon". Edhe tha, "A po vjen nesër n'prova? Emri jonë i bendit osht' 'The Strings'" (qeshë). Kaq, filloi muzika për mu.

E prej atyshit një vjet kemi ushtru me ta n'podrum. E kemi pasë podrumin te ai. Aty o kanë shumë lezet njeri, qaty e bona bendin e parë. O konë shumë shumë lezet. Për mu o kanë periudha ma e mire që e kom pasë *teenage* deri sa u pjeka pak ma shumë që, po menoj, çka dojsa me pasë në jetë teme edhe *svirka*¹⁸ e parë... e bona *svirkën* e parë o njeri! E gjojta vendin për *svirkë* t'parë. O kanë në Klinë, o njeri, ku kena bo muzikë. O kanë një Hard Rock n'Klinë edhe e kemi bo atje, e bomë një *svirkë*. I kishin një 25 kangë, edhe i knumë krejt 25 kangë. U knaqën gjinja, na thirrën mas dy jave prapë. Masi shkumë n'Pejë, jo erdhëm n'Prishtinë, a p'e din qysh... kalojë ca vjet. E morra pjesë në "Ethet e së Premtës", kom marrë pjesë. Në atë kohë isha pak...pisha bari a ku ta di une, si tanë të rijtë. Bari duhet me u liberalizu faktikisht. Vizat (qeshje), po... se m'u lidhë. Po edhe në "Ethet e së Premtës" në natën e fundit që e kisha me kalu në dhetshen, unë isha shumë tokë, me t'kallxu të drejtën. E ajo ish, s'e di. Kaloi qysh kaloi edhe une isha edhe tu punu si zdrughtar në atë kohë...

¹⁸ Serbisht: *svirka*, me lujt muzike ne klub nate. Ne zhargonin e shqipes njihet si *svirke*.

Erëmirë Krasniqi: A kalove në dhetëshe a jo?

Bajram Kafu Kinolli: Jo s'kalova n'dhetëshe se e dhiva (qeshje). E dhiva shumë aty. Edhe tu punu si zdrugthtar isha n'atë kohë me vëllavin bashkë.

Erëmirë Krasniqi: Në Shqipëri?

Bajram Kafu Kinolli: Jo, këtu!

Erëmirë Krasniqi: Me u solidarizu me shqiptarët tonë...

Bajram Kafu Kinolli: Me njerëz të mirë (qeshje). Si kisha quajhtë shqiptarë veç, s'e di këta janë kosovarë t'mirë, se po dojnë me i definu. Po menoj, po, daja o konë ashtu...daja i babës, dajë e thirrësja, daja Hadi. O konë shumë interesant si njeri, përnime o konë shumë karizmatik, e bojke humorin shumë t'mirë. Taman njeri që ka jetu, përnjime ka jetu shumë. O konë kuzhinier, ka punu n'spital njeri. Gatujke shumë mirë! A din sa mirë gatujke? Shumë sene kom mësu prej tijna ashtu, me gatu, jahni me kepë, ose tavë me patlixhana ose pasuli qysh gatuhet, qysh bohej mijone me ja qitë, sa duhet m'u përzhitë mijonja, edhe m'msojke qësi sene. O kanë shumë asi, bash që kisha nevojë për një...përderisa e hupa une babën, e hupi baba koncentrimin, e hupi ato... edhe une kisha nevojë për një qasi njeri. E ish ai aty, diqysh e zavendësoi atë vendin.

E përveç asaj, seni tjetër, muzikën njeri. Ai ashtu shumë i madh si muzikë, shumë t'u kriju, shumë sevda që thojnë n'Gjakovë, shumë ashk¹⁹, ashik ashtu, taman knojke me zemer. E tona here ma bojke, "Kqyre, kur t'knon, leje kush osht' përpara aty, kush osht' me ty, kush osht' aty. Msheli sytë e kno! Kno prej qetushit {i mëshon gjoksit}, qëtu duhesh me e ni. Kno, qite zanin, pse po tutesh! Qite zanin". E tanë kohën ashtu më bërtitke, "Pse p'i jep zor, pse p'i jep zor?" Ashtu kur bojsha naj gabim a najsen. Po menoj, mama, mama s'e di, se kom ni asnjihere n'kontrabas. S'e di! E kom ni njihere tu knu, o kanë shumë e mirë, edhe e knojke Nexhmije Pagarushën. E kishim radion, u konë shumë moti ajo, o konë për vit të ri. Ish t'u bo peshk, t'u përzhitë peshkun, edhe ish Nexhmije Pagarusha diçka, o kanë kjo kanga "Baresha" po m'doket. Edhe po knon kjo shumë me zo ashtu taman t'naltë. Kërkush n'shpi, se krejt kishim dalë te gjyshi e gjyshja knena. Edhe une po hi kadal-kadale, se tona here jam kanë shumë i ngadalshëm, i trashë o njeri, shumë jom konë i trashë si njeri kështu. Si i vogël jom konë shumë i trashë. Edhe po hi mrena kadale, po e ngoj, e si m'ka pa mu {shtanget}... u nal. Edhe kurrë s'e kom ngu masanej t'u knu edhe o konë interesant.

Po nejse kjo s'ma ka prishë, si do sene po menoj nuk kemi pasë shumë komunikime të thella... "Çka po bon? Ku po shkon?" Ma shumë o konë te shkolla që m'ka shty, "Shko n'shkollë! A i ki bo detyrat?" A p'e din. Tonë kohën m'kontrollojke kjo edhe pse ka punu tonë kohën, ka punu tri-katër puna. Gjashtë fëmijë m'i majtë o konë shumë vështirë. E prej ksajna une e kom mësu që sa ma shumë që t'punon, kur t'vjen fundi i ditës, edhe e din çka ki bo edhe ki bo për dikon mirë, *it doesn't*

¹⁹Turkisht: *a k*, dashuni, pasion.

matter if you are tired, tomorrow you gonna be a new one [nuk është me rëndësi nëse je i lodhur, nesër do të jesh person i ri].

E tanë kohën ma bon qështu, “Veç puno. Qetash e ki kohën me punu! Kqyre qysh jom bo une” (qeshë). A e din ashtu qysh e ka asi tripi... e osht’ e mirë. Nuk ka shumë fjalë, nuk asi *deep* [thellë] se garant s’e kanë lonë kur o konë e vogël, se o konë e shtata fëmi atje, plus u martu e re. E s’e kanë lanë shumë ashtu garant me... po menoj që s’e kanë lonë shumë me folë. Kështu që, zakonisht tradicional te na osht’... E garant ish konë shumë ndryshe t’ish konë n’shkollë (qeshë) mos t’ish martu për shembull.

E influencë tjetër për muzikë, po menoj osht’ edhe muzika e sufizmit. Une kom knu shumë nëpër teqe ilahi. Faktikisht i kom ditë nja ni qind ilahi përmendësh që kur shkojsha me babën u dufsha m’u kanë i përgaditun, “Ti je djali i shehut!” Çfarëdo ilahi me t’thonë, një dervish apo dikush me t’a kërku, ti u dufshe me ia knu. Po s’e dite, ti ia more vetes ftyrën edhe babës tond. Kështu që, e ka pasë njifar hierarkie, përgjegjësie, tanë kohën u kanë ajo, por une diqysh me lezet e bojsha ata, e bojsha me lezet. Çka tjetër...

Erëmirë Krasniqi: A i kuptojshë ti ato ilahi?

Bajram Kafu Kinolli: Paj, e kuptojsha shpirtnisht o njeri ato, se une jom konë i lidhun me qato. Jom kanë bajagi shumë sufi, ashtu mrena. E qajo ma ka jep atë butësinë, qajo ma ka japë atë *calm down*, *think about* [qetsohu, mendo], a p’e di qysh, nije para se me e bo senin. E sufizmi osht njifar energjie qe kurrë s’e kom kuptu pse m’bon qashtu mu kur flas për to. E kom njifar... {prekë barkun}

Erëmirë Krasniqi: *Fuzzy* [të trazumë].

Bajram Kafu Kinolli: Po de, si *the birds are in my stomach* [zogjtë në barkun tim] e kam njifar seni. Edhe pse kohën e fundit nuk jamë shumë aktiv në besime me t’thonë të drejtën, por faktikisht e respektoj sufizmin për një sen qe e kanë. Misticizmin shumë t’zhvillumë, i kanë do storie shumë të mira edhe më duken se janë *punk of the muslim*, diqysh janë *revolutionary* [revolucionarë] (qeshje). Nuk kanë asi... s’e di. Do thojnë që pijnë alkohol, do që s’pijnë alkohol, diqysh. Te une personalisht, une kom pa këtu që pijnë alkohol. Osht’ shumë e vërtetë që pijnë alkohol, por nuk i bojnë qato sene që flasin gjinja, që flasin që bojnë *group sex or something like that with women that turn* [seks në grup me gra që shndërrohen]... a e din, e nalin dritën e bojnë ksi sene. Nuk osht’ qajo e vërtetë!

Erëmirë Krasniqi: Ekzistojnë qato paragjykime a?

Bajram Kafu Kinolli: Janë... po de ekzistojnë qato paragjykime. Kështu që, nuk janë qata. Eh qato sufizmi ma ka japë atë ndjesinë si për muzikë. Daja ma ka jepë atë “*Be present!*” [Ji prezent], “Hajde jepe!” E mama...s’di çka m’ka jepë... noshta që m’ka lindë ajo mu (qeshet). Qata po, qata e di që m’ka bo ajo. M’ka rritë po, deri në shtatë vjet kom flejtë me to (qeshë) kështu që o kanë super.

Erëmirë Krasniqi: Kafu, a po na prezenton qet' dhomë?

Bajram Kafu Kinolli: Po a?

Erëmirë Krasniqi: A po na e lexon?

Bajram Kafu Kinolli: Qekjo o skica që e ka maru vëllau jem. Edhe qekjo osht' tyrbja, domethanë forma e tyrbes qysh duket tyrbja e babës. Që thojnë tyrbja e Babës Ukshin qetash, kohën e fundit edhe shkohet ditën e dytë të Shën Gjergjit me e vizitu, se e kanë ditën e caktume. Zakonisht nuk e di pse Shën Gjergji lidhet me sufizmin qaq shumë për me i vizitu tyrbet. Osht' shumë interesant edhe shumë e respektojnë faktikisht te sufizmi ditën e Ederlezit ose Shën Gjergjit. Hala s'e kom kuptu qet' sen. Qet' sen duhna me e hulumtu pse bash saktësisht janë qaq t'lidhun, se faktikisht Shën Gjergji osht' njëfar festë shumë pagane. Po nashta që osht' prej romëve, janë ata që e kanë përcjellë ma shumti deri këtu edhe muret m'u kanë qajo lidhje. S'po di, qashtu po menoj. Por duhna me e spjegju.

Tjetër... {shikon rreth e rotull dhomës} i kallxova krejt. Ah këtu janë, qekjo fotografi osht' shumë interesant {merr një fotografi në dorë}. Qitu ndahen degët e sufizmit për shembull, osht' shumë interesant. Na jemi Halveti, po menoj familja jonë osht' Halveti. Kah mama janë Rufai, n'Gjakovë kemi Sadi... edhe Bektashi. Po menoj, baza e Halvetive osht' në Prizren. Qikaq e di une, kom harru shumë sene faktikisht se s'jom bash shumë aktiv, edhe po m'vjen shumë marre.

Pjesa e Tretë

[Intervistuesja kërkon nga folësi të spjegojë rreth ritualeve të Helvetive dhe rolit të teqës. Kjo pjesë është prerë nga video intervista].

Bajram Kafu Kinolli: Paj, këtu rituali osht', quhet Zikër, ose Ziqër që zakonisht n'Gjakovë përdoret. Halvetitë e kanë... shumë normale, si t'gjithë sektet tjera të muslimanizmit, që i kanë t'gjithë degët tjera. Por, veç ndryshon, aty-këtu, suret e Kuranit, zakonisht shkon nëpërmjet sureve të Kuranit, osht' e njejtë. Pastaj e kanë, janë dy faza të Zikrit. Osht' Zikri që rrinë ulë, Zikër ulun edhe Zikër n'kamë. Zikër ultë, osht' me zo dhe me trup, tonë kohën n'lëvizje. Zikër n'kamë, janë Kudumi, osht' një instrument që osht' si në formë të tarabukit por që marohet me lëkurë t'dhisë, edhe e ki po menoj jonë edhe zilet, që i thojnë n'Gjakovë, jonë zilet çinella, ose *cymbals* n'anglisht që përdoren.

Por zakonisht kur osht' natë e madhe, si për shembull Sulltan Nevruzi, që quhet si viti i ri i tokës, viti i ri, i shpirti i tokës hin, osht' dita e pranverës, osht' shpirti i tokës po hin, kryhet gjithë ai... manifestim i ftohtë që e murrë prej Abrahimit e Osmanit e plakat, a ku t'a di une, osht' muaji Sulltan Nevruz, që osht' si viti i ri, qaty marrin asi rituale që zakonisht i kushtohen njëfar energjie. Shpuhen, po menoj, osht' shumë normale. E zakonisht te Halvetitë e kanë shpumjen, e kanë n'sy, shpuhet nëpërmjet këtu {tregon me gisht në pjesën e poshtme të syrit}. E kanë n'bark, e kanë edhe qitu

{tregon me gisht në faqën e dajthtë të fytyrës} edhe zakonisht e kanë me shpatë. I hypë një person shumë i ronë n'bark, edhe kurgjo s'ndodhë, a p'e dinë, osht' shumë interesant ajo.

Unë e kom bo shpeshherë, babën tem m'a kanë shtri edhe i kanë hypë. Edhe ashtu n'fillim u konë shumë e çuditshme por masnena fillon e t'bohët, nuk je qaty mo. Je pjesë e një, s'po di, osht' njëfar energjie tornado që shkon brenda asaj që nuk muj me shpjegu faktikisht. Ajo ndodhë veç kur je shumë i pastër edhe kur je shumë i dedikum n'qasi energjie. Osht' njëfar lloj fiziku që tonë kohën je t'u lujtë edhe po m'doket që hin n'hipnozë, n'trans. Edhe u konë shumë e mirë, osht' njëfar seni shumë i mirë. Kur kryhet ajo, osht' si m'u lindë masparti, m'u çu prej mëngjesit se m'e lindë nuk e di, s'e mbaj n'mend. Por, me thonë saktë, osht' si m'u çu prej mëngjesit, e ki pasë një natë t'mirë, ki flejtë n'gjumë, edhe pse je i njersitur, ndihesh qaq freskët, qaq, s'ki nevojë me folë hiç. Asnjoni s'folë veç rrijnë, osht' shumë qetë. Osht' shumë interesant qai sen, shpesh herë e kom ni qata, nuk munesh me ni për çdo herë kur e bon, por shpesh herë e nin. Kur je i dedikumë, osht' njëfar lloj i meditimit, thjeshtë. Kjo osht', po menoj, për Zikër, por ka edhe mënyra tjera që e perdorin, po menoj, sidomos nëpër degë tjera të sufizmit.

Erëmirë Krasniqi: Ku jonë konë teqet n'kohë pak ma t'vështira, edhe çfarë roli politik kanë pasë, sidomos kur u konë puna me u organizu për luftë?

Bajram Kafu Kinolli: Paj, po menoj tek, te na familjarisht, na jemi konë shumë ashtu t'limitumë me organizu asi sene. Zakonisht, që i kemi pasë, një gjeneral edhe një bishë tjetër këtu, që kanë qenë tonë kohën n'kontroll knena. S'kemi mujtë me pasë asi rituale kohën e fundit, hiç s'ka guxu. Por, po menoj ka teqet që kanë bo. Tonë kohën kanë jap kontribute për mbledhjet politike, për mbledhje e sene. Unë kom ndëgjju prej shumë... po menoj kur shkojshim për shembull nëpër teqet tjera me babën, tonë kohën jonë konë ata fjalimet okolla që o ka bohët diçka, që duhet m'u konë t'pregaditun. Po menoj, si i vogël, nuk e kom marrë qaq shumë vesh se sjom konë... une zakonisht kom shku aty kur m'ka marrë baba jem, "Hajde me knu!" A p'e din qysh? Qaty jom konë, po unë ngojsha por diqysh nuk u konë ajo interesimi ma i madh se sa me kallxu veten sa mirë di me knu, po menoj, qaty m'shtijke ai me bo. E zakonisht i kom ni.

Po menoj, ka storie t'Rahovecit, n'teqe t'Rahovecit, aty që kanë ndodhë. Ka storie n'Gjakovë që ka ndodhë. Po menoj, gjithmonë teqet jonë konë asi, si vendi ku jonë taku, ku ka menu komuniteti, ku kanë menu liderat e fshatit ose liderat e një pjese të mahallës që çka ka me ndodhë me neve, jo vec në luftën e fundit, por edhe ma herët nashta. E ka njëfar, osht' thjeshtë si oda. Teqja osht' një odë, a p'e dinë qysh? E ka një qasi tripi, osht' shehi, osht' ai plaku, a p'e dinë qysh? Sheh kur e përkthen osht' plak faktikisht, osht' urtësi, osht' i urti, osht' ai që folë pak por kur folë pak, qata i thojnë. Edhe mu m'doket shumë e njejtë, shumë e lidhun kjo me këtë kulturën e Kosovës, sidomos në Gjakovë, osht' shumë, ashtu, ka shumë.

Edhe pse sot dëgjova do komente që, po menoj prej Anës, a e ndëgjova prej teje sot, a po? Që dikush po thotë që n'Gjakovë s'ka sufizëm, s'ka muslimanizëm. *No, it's been always here*, kështu që

u konë tona herë këtu. Gjinja ka shumë këtu, edhe hala jonë t'u e përcjellë, edhe shumë mirë që osht' t'u përcjellë, se qikjo e man komunitetin. Qikjo osht' njifar lloj historie që na ka mbetë, ndoshta e vetmja. Osht' njifar rituali që na ka metë e vetmja, që nuk i bon dam kërkujna, osht' shumë spirituale, osht' shumë për vete. Edhe përderisa ka japë kontribut edhe pse kanë vdekë shumë njerëz brenda teqës, që na i thojmë shehid, i bjen shehid kur vdes në teqe. Po menoj, aty ka pasë diçka, a p'e dinë qysh? Nuk jonë hi veç me vra. S'po di qysh u konë storia veç, u konë njifarë *gathering* [mbledhje] aty që kanë bo diçka, për takime të ndryshme. Se Gjakova u konë zakonisht, tona herë, u konë ajo pjesa ku ka vujtë ma s'shumti, ku ka pasë ma s'shumti, tona herë sevda. Ku ka pasë ma s'shumti besim, muj me thonë, n'këtë aspektin, une qashtu sa kom ndëgju.

E teqja ka lujtë rol, rolin aty, por ku kanë mujtë m'u mbledhë tjetër a p'e din qysh. Zakonisht policia, me sa e di une, nuk kanë prekë shumë përpara. Domethonë, prej '90-ave nuk i kanë prekë shumë teqet e xhamiat e këto senet. Qaty kanë shku edhe n'shköllë faktikisht, a p'e din qysh. Jonë konë qaty venet e shkollës së mesme, fakulteti, qaty kanë shku. Xhamiat, jonë konë pjesa, masanej e rëndësishme, u konë naj shpi private por teqja u konë ai veni që je shku m'u falë, edhe s'ta ka prishë, se u konë qashtu, s'ta ka prishë, a p'e din, thjeshtë osht' një besim edhe s'munesh me ia nalë dikujna. Edhe e ka lujtë rolin e vetë

Erëmirë Krasniqi: E n'luftë këta shehid që kanë ra...

Bajram Kafu Kinolli: Po?

Erëmirë Krasniqi: Thojnë që e kanë pasë ni rol t'randësishëm me organizu, n'pjesën e organizmit të luftës. Çka ke ndëgju?

Bajram Kafu Kinolli: Po, une personalisht, nuk di saktësisht. Por ish konë shumë mirë me, nashta, me shku atje me vetë, edhe me ta tregu saktë, se s'po du me japë dezinformata, kështu si person. Edhe e di që ka, ka ndodhë diçka aty. Po menoj e di që, e di n'atë aspektin kom marrë vesh por s'kam saktësisht, nuk kom fakte, nuk kam... kush osht', me emër e kësi sene.

Për shembull, me kqyrë sufizimin n'Turqi, nuk osht' e lejushme. Osht' njifar sekreti kjo, osht' ni shoqëri sekrete këtu mrena. Këta nuk i tregojnë çka bojnë mrena faktikisht, kërkush nuk guxon me ditë çka bohet mrena, hiç kërkush! Përderisa jonë krejt, jonë, për shembull, vijnë një qind veta, n'secilin një qind veta, osht' një anëtar i shpisë, osht' lideri i shpisë, munet m'u konë. Edhe qai lideri i shpisë i ka edhe dy-tre vëllazën, domethonë, qëtu osht' marrë vendimi, atje osht' shpërnda edhe osht' shpërnda ma shumë.

Munet... qikjo ka ndodhë për shembull. Kur u konë, një shembull shumë konkret. E ka marrë dikush një libër, u ardhë një libër i ri për shembull, me msu ça osht', prej kahit ka ardhë një person shumë i çmumë prej Turqisë që ka bo shumë mirë, po menoj u konë sheh, e kësi sene. Kur u ardhë n'teqe njëherë, mbrena dhetë ditëve u përhapë n'krejt teqet e Kosovës që qai liber ka mbërri këtu. Osht'

qaq informacioni, osht' qaq i shpejtë, domethonë, mënyra e informimit nashta u nda prej teqës. Për shembull, baba jem u konë shumë merakli në libra, ka lexu shumë. Edhe kur i bijke, e ka pasë një shok prej Turiqsë, edhe i vijke, ton kohën i vijke, bile blejke edhe do sene t'vogla. I ka do... e ka pasë ble një shpatë që osht' bajagi shumë e vjeter, kështu doket, nuk e di a osht' taman kështu si asi. Edhe kur ka marrë, për shembull, e ka marrë një libër "Hadithet e Mamalisë", që n'Kosovë nuk ekzistojke, a pe din qysh, qaj libër. Edhe ky tipi e patë gjojtë n'gjuhën serbo-kroate, n'Kosovë nuk i bjishin ata libra, se u konë prej Bosnjes, Bosnia n'luftë hala. Edhe kur u ardhë këtu për herë t'parë, krejt teqet murrën vesh edhe erdhën e bonë kopje, a pe dinë qysh. U konë shumë interesant ajo lidhja qysh u konë. Njo si t'a merrke vesh, nuk osht' nashta ky stereotipi që gjakovarët, që shprëndahet fjala, por u konë për me shpërnda dijeninë, domethonë, dijenia, urtësia u konë, u shpërnda prej këtuhit, u shpërnda prej teqeve.

U konë, nashta ka pasë edhe sekretet e veta, diqysh, une s'muj me majtë n'men se jom konë shumë i vogël n'atë kohë. Nuk jom konë n'atë *state of mind to* [gjendje mendore] a din me gjyku n'qatë menyrë. Por, sa e di une osht' qajo mënyra qysh osht' shpërnda, u konë, u konë shumë përnime, ashtu për dy-tre ditë, për dhetë ditë u bojke shumë e madhe. "Oh, ky e paska këtë libër", "Oh, ky e paska këta", "Oh, qiky ka nevojë". Për shembull u konë shumë interesant kur e kemi maru shpinë, krejt komplet, domethonë, ka bo krejt t'premtën, t'dillën kemi pasë nevojë për punëtorë me qitë një plloçë t'shpisë. Domethonë, t'premtën jonë ardhë ktu edhe kanë thonë, për shembull baba jem ka thonë, "Unë po kom nevojë për dhetë njerëz, me ardhë nesër me m'ndihmu, i kom qikaq" po menoj "I kom qikaq sene, po mungojnë qikaq, qikaq". Domethonë t'nesërmen nuk i ke pasë dhetë veta, po i ki pasë 30 veta, me bukën, me kejt senet e marume, edhe hijshin, punojshin, e kryjshin për gjysë dite. U ulshin, pijshin, natën e mirë!

Edhe u konë qikjo roli i teqës që ka bo njëfar lloj komuniteti shumë t'mshelët. Shumë dashni ka pasë, qaq shumë dashni ka pasë, nuk e di a ekziston qitash qajo dashni. Se tash kjo koha e komercializmit, koha e kapitalizmit osht' pak, e ka nda këtë, s'po di... as sekt s'muj me qujtë, po s'po di, osht' si një komunitet. Ky osht' si njëfar lloj, u konë shumë i bukur si... '90-tave osht' konë shumë e nevojshme për me pasë diçka, për m'u dashtë me njoni-tjetrin, pa marrë parasysh. M'u kapë me dikun se u patëm shpërnda, s'dijshim ku me shku. E veni sekret u konë qeky.

Jeta osht' shumë e mirë, shumë e bukur edhe po menoj që veç duhesh me dashtë veten pak ma shumë, m'u kujdesë, edhe kur ti je mirë, po menoj, njerëzve ki me ju bo shumë mirë. Une jam ma mirë sesa disa njerëz që kanë probleme që i njoh, për shembull. Jom okej, kom marrë atë hovin tem, jom t'u bo, jom t'u punu n'organizatë si financier. Jom t'u bo muzikë me Gipsy Groove. I kam dy albume. Po menoj, me Gipsy Groove, osht' një sen që, që ka ndodhë n'Prishtinë, ia ka nisë para 5 vjetëve edhe e ka bo njëfar revolucionit t'vetë, t'vogël. Po menoj, e kemi qitë muzikën rome n'një aspekt që m'e ndëgu tjerët jo veç romët. Edhe qajo, u konë njona prej fillimit t'misioneve t'mia. Albumi i dytë, u konë, i ka do sene që flet për të drejtat e femrave, barazia gjinore, e ka liria e lëvizjes, i ka. Po menoj osht' n'përgjithësi n'atë aspektin, jemi super me bend. Me bend jam shumë

okej. Jemi t'u bo muzikë gjithkah edhe nuk isha anku, ashtu, nuk isha anku hiç për muzikë, osht' super mirë.

Por, tjetër, pjesa tjetër, une jom i martumë (qeshë) që tetë vjet gati jemi bashkë. Edhe shumë interesant pas krejt atyne që m'kanë ndodhë n'jetën time, edhe osht' bajagi një tranzicion gati që 20 vjet, kështu, me kqyrë hollë e hollë, edhe m'ra një çikë shumë e mirë. Po menoj, një gru qaq e mirë sa që mu m'ka bo, osht' një shtyllë për mu. Besomni që osht' shumë një shtyllë për mu, osht' Milica. Milica osht' prej Serbisë, edhe po jetojmë bashkë tash n'Novi Sad. Ajo po studion fotografi, punon pak n'organizatë qaty me neve. Kështu që *it's fine*, osht' pozitive, osht' shumë... Ajo ka ardhë n'Prishtinë me jetu njëherë, njëherë jena konë. U konë një serbe, me ardhë në 2010-tën n'Prishtinë, por nuk u konë qaq keq n'Prishtinë por me ardhë me jetu me një romë që osht' i paragjykmë, diqysh osht' *double trouble* [dyfish problem] a pe din qysh, (qeshë) a dinë. U konë, *wow, she is so brave!* [uau, është shumë e guximshme].

Ajo, n'momentin kur une e kom pasë ma t'keqin, masi jom kthy prej Shqipnisë. N'momentin që kom nisë me ra ashtu për iniciativë krejt, dulë ajo {ngritë dorën} edhe e bona Gipsy Groove, e bona audiencën teme n'Prishtinë, e bona rrethin. Tash e kemi një festival që jemi t'u e bo bashkë me Dit' e Nat'-in. A din qysh, kaniher kur e kqyrë krejt, ky...

Erëmirë Krasniqi: Trajektore.

Bajram Kau Kinolli: Trajektore e jetës osht' m'varet ku ti don me pozicionu vetën. Viktimizim, boll mo! A din qysh, s'ka mo me ulë vetën, jo, "Ky osht' ma i mirë, ky osht' prej atjeshit, ose ky prej ktushit, ose ti e ki këtë lëkurë, une se kam këtë lëkurë, ose une e kam pozitiv, ose negativ". *It's about* [bëhet fjalë] ku don me shku. Edhe qita ma ka mësu ma s'shumti Milica, për shembull. *Yeah, without woman, it's impossible* [Po, pa gruan, është e pamundur](qeshë). Kështu që, *it's okay, it's fine* [është në rregull]. Edhe duhet me kalu njeri, krejt çka ka ndodhë osht', ka ndodhë edhe nuk mundesh me kthy mrapa. Osht' pasojë por prapë, duhesh me punu me veten, a pe din qysh. Serb, shqiptar, romë, ku osht' esenca? Diqysh jonë terme, jonë emrime që s'ka nevojë m'u konë por sistemi osht' qashtu, okej, krejt n'rregull. Por dashuria s'ka njeri aty, s'njeh kurgjo hiç, edhe super o njeri. *I love her. It's good.* [E dua atë. Krejt është mirë] (buzëqeshë).